



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 04 257 – 924*

Nr. 1119/99.Prot.

Tiranë, më 31.12.2016

**V E N D I M**

**Nr. 188, Datë 31.12.2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 27  
SUBJEKTE**

**“MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË REKOMANDUARA NË  
AUDITIMET E MËPARSHME PËR PERIUdhËN 3 MUJORI I FUNDIT TË VITIT  
2015 DHE 9 MUJOR I VITIT 2016 ”**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, në auditimet e evaduara për periudhën e tremujorit të fundit të vitit 2015 dhe 9 mujorit të vitit 2016, sipas programit të auditimit nr.1119, datë 05.11.2016 dhe programit nr. 1119/25 datë 14.11.2016 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr.1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se në **27** subjekte të audituar, janë rekomanduar gjithsej **987** masa, nga të cilat janë pranuar **952** masa ose **96.5%** e masave të rekomanduara, (për të cilat nga subjektet janë përfshirë në plan veprimet për zbatimet e tyre) dhe nuk janë pranuar **35** masa ose **3.6 %** e rekomandimeve gjithsej. Konstatuam se nga masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **367** prej tyre ose **38.6 %**, pjesërisht **69** masa ose **7.2 %**, dhe konsiderohen në proces zbatimi **378** masa ose **39.7 %**. Nga auditimi rezultuan **138** masa të pazbatuara të cilat përfaqësojnë **14 %** të masave të propozuara.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

- 1. Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar **8**, nga të cilat janë pranuar **7** masa. Rezulton se nga rekomandimet janë zbatuar **4** rekomandime, janë zbatuar pjesërisht **1** rekomandim, pa zbatuar **2** rekomandime dhe pa pranuar **1** rekomandim.
- 2. Masa organizative** janë rekomanduar **457**, nga të cilat nga të cilat janë pranuar **448** masa ose **98 %** e tyre, *të pa pranuar 9 masa.* Nga masat e rekomanduara, janë zbatuar **134** rekomandime, zbatuar pjesërisht **13** rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatim **253** rekomandimeve , *nuk janë zbatuar 48 rekomandime* dhe nuk janë pranuar **9** rekomandime.

3. **Masa zhdëmtimi** janë rekomanduar **219**, për vlerën 1,485,037 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **202** masa në vlerën 1,398,401 mijë lekë, *nuk janë pranuar 17 masa në vlerën 86,636 mijë lekë.*  
Nga masat e rekomanduara janë zbatuar **35** rekomandime në shumën 138,816 mijë lekë, pjesërisht janë realizuar **33** rekomandime në vlerën 42,330 mijë lekë, në proces zbatimi **96** rekomandime në vlerën 758,717 mijë lekë, *nuk janë zbatuar 38 rekomandime në vlerën 458,539 mijë lekë dhe pa pranuar 17 masa në vlerën 86,636 mijë lekë.*
4. **Masa administrative** janë rekomanduar **13**, nga të cilat janë pranuar **8** masa.  
Nga masat administrative të rekomanduara janë zbatuar **2** masa, janë në proces **5**, pa zbatuar **1** masë dhe pa pranuar **5** masa.
5. **Masa disiplinore** janë rekomanduar **267**, ku janë pranuar **264** masa disiplinore.  
Nga masat disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **193** masa, zbatuar pjesërisht **22**, nuk janë zbatuar **49** masa dhe nuk janë pranuar 3 masa.
6. **Masa për “të ardhura dhe shpenzime” jo në përputhje me parimet e efikasitetit dhe ekonomicitetit** janë rekomanduar **23** masa në vlerën 20,223,508 mijë lekë, ku 22 masa në proces, pa realizuar 1 masë në shumën 71,169 mijë lekë. Shuma e arkëtuar gjithsej 880,533 mijë lekë ( arkëtuar detyrime të prapambetura në UK Tiranë).

Bazuar në korrespondencën me subjektet brenda afatit 20 ditor, lidhur me planin e masave për rekomandimet e lëna gjatë auditimeve, referuar dhe auditimit të zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e rekomanduara, *nuk janë pranuar rekomandime nga disa subjekte*, ku përmendim subjektet:

1. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë nuk ka pranuar 3 masa shpërblim demi në vlerën 6,617,5 mijë lekë.
2. AAC nuk ka pranuar 3 masa organizative dhe 2 disiplinore.
3. Bashkia Tiranë për projektin “Rikonstruksioni i Rrugëve lokale dhe sekondare në Bashkinë Tiranë” nuk ka pranuar 4 rekomandime për masa organizative dhe 1 shpërblim demi në vlerën 96.3 mijë lekë.
4. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec (auditimi i plotë), nuk ka pranuar 10 masa shpërblim demi në vlerën 4,965 mijë lekë.
5. MZHETTS dhe MF (auditim tematik mbi këshillat mbikëqyrës) nuk kanë pranuar 1 masë përmirësimi ligjor.

Konstatohet se 8 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara, kurse 2 subjekte kanë kthyer përgjigje jashtë afatit, veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Konstatohen 11 subjekte që nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ku citojmë: FSHZH, MPB(projekti “*Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës*”, Albkontroll sha, Bashkia Tiranë( projekti “*Rikonstruksioni dhe zhvillimi i rrugëve lokale dhe sekondare*), MZHETTS dhe MF( *auditim për këshillat mbikëqyrës*), Spitali Rajonal Durrës, Ujësjetllës Kanalizime Durrës,Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, Ujësjetllës Kanalizime Mirditë, Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë, OST.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të

Huaja dhe Shoqërive Publike shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimet e mëparshme”, e të ushtruara në 27 subjektet të audituara në tremujorin e katërt të vitit 2015 dhe 9 mujorin e vitit 2016.

**II. TË RIKËRKOJ** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

### **1. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

*(Për projektin “ Rikonstruksioni i Aksit Tiranë Elbasan”)*

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 30.06.2014 deri më 30.06.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.100, datë 7.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.508/7, datë 07.09.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën 7421/5 datë 09.11.2016 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Kthimi i përgjigjes është jashtë afatit kohor të 20 ditëve nga marrja dijeni me shkresën e KLSH nr. 508/7, dt. 07.09.2016. Referuar shkresës së kthimit të përgjigjes, titullari i ARRSH me shkresën nr.7421/1, date 7.11.2016 ka urdhëruar Njësinë e zbatimit të projektit “ Ndërtimi i Rrugës Tiranë Elbasan” për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Gjithashtu me dokumentin me nr.7421/2, date 07.11.2016 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH “Program pune për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Projektin” Ndërtimi i rrugës Tiranë –Elbasan” . Ky program ka të përcaktuara drejtoritë përgjegjëse si dhe afatet kohore të realizimit të rekomandimeve.

-Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka kthyer ende përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Në momentin e mbajtjes së këtij Raporti Auditimi, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 ( nëntë )masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 9 dhe nga këto masa janë zbatuar plotësisht 2, janë në proces 3, janë të pa zbatuara 3 rekomandime dhe i zbatuar pjesërisht 1.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 7 ( shtatë ) rekomandime në vlerën 2,410,782.6 USD dhe 51.635 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 7, janë në proces 2 rekomandime në vlerën 204,866.9 USD janë të pa zbatuara 4 rekomandime në vlerën 2,205,915.7 USD . Është

zbatuar 1 rekomandim ku shuma e arkëtuar është papërfillshme në krahasim me totalin, vetëm 51.635 lekë.

c. Shpenzime dhe të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit janë lënë 2( dy) masa në vlerën 512,947.8 mijë lekë dhe janë në proces 2.

d. Janë rekomanduar 3 ( tre) masa disiplinore gjithsej si më poshtë vijon:

- Sipas **Kodit të Punës 2 ( dy) masa disiplinore e përkatësisht; “Vërejtje me paralajmërim”** të cilat janë zbatuar me të njëjtin nivel.

-Në kompetencë të titullarit të ministrisë dhënë masa “ **Largim nga detyra” 1( një) masë e cila është pranuar dhe zbatuar;**

e. Është rekomanduar **1 masa administrative**, gjendja e të cilës paraqitet;

Bazuar në Udhëzuesin për Konsulencë, sipas financimeve të B I Zh pika 1.d dhe 1.17, i është kërkuar Autoritetit Rrugor Shqiptar:

Të shpallë të papranueshëm 2( dy) shoqëri, për lidhjen e kontratave për shërbime konsulence si dhe të marrë masa për njoftimin e B I Zh mbi performancën e dobët të këtyre kompanive. Nga ky rekomandim për njërin nga shoqëritë e konsulencës, nga KLSH është pezulluar afati i zbatimit deri në fund të kontratës dhe kjo të realizohet referuar korrektiveve të gabimeve dhe performancës deri në fund të zbatimit të kontratës dhe për shoqërinë tjetër afati i zbatimit të rekomandimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH për strukturat është vendosur deri në fund të vitit 2016.

Në përfundim i rikërkojmë Autoritetit Rrugor Shqiptar, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 508/7, datë 07.09.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të Projektit” Ndërtimi i rrugës Tiranë –Elbasan” të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, përse kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim 1**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

*menjëherë*

### **Rekomandim 6**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Supervizorin, t’i kërkojnë Kontraktorit të paraqesë analiza të sakta të çmimeve që kërkohen për realizimin e rialokimit të shtyllave të tensionit të lartë për Usekun e Mulletit dhe Rrëshqitjen e Ibës, duke bërë rregullimet në preventivat përkatëse.*

*menjëherë*

### **Rekomandim 7**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori t’i kërkojnë kontraktorit marrjen e masave përkatëse për eliminimin e ndotjes së mjedisit. Të bëhen studimet përkatëse dhe të kërkohet leja për depozitim të përhershëm të mbetjeve që rezultojnë nga gërmimet në vende të cilat nuk kanë ndikim negativ në mjedis.*

*menjëherë*

### **Rekomandim 8**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori të kërkojnë nga organet kompetente revokimin e lejes mjedisore për vend depozitimin në Fshatin Lundër me sipërfaqe 36938 m<sup>2</sup>, si dhe të merren masa për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në këtë zonë.*

*menjëherë*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim 1**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, referuar Kontratës së punimeve civile “Ndërtimi i segmentit Sauk-Tunel i Krrabës”, të zbresë nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **1,601,169.6 USD**. Krahas zbritjes së kësaj vlere, të merren masa dhe të përlllogariten në detaje të gjitha punimet e realizuara në Usekun e Mulletit, të cilat janë shkatërruar si pasoje e ndryshimit të projektit, në përgjegjësinë e Kontraktorit.*

**menjëherë**

### **Rekomandim 2**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, referuar Kontratës së punimeve civile “Ndërtimi i segmentit Sauk-Tunel i Krrabës”, të zbresë nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **316,329 USD**, vlerë e pa argumentuar, e pa justifikuar dhe përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve**

### **Rekomandim 3**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **286,660 USD**, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve**

### **Rekomandim 4**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **168,149.4 USD**, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve**

### **Rekomandim 5**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **36,717.5 USD**, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve**

### **Rekomandim 6**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit [REDAKTUAR] vlerën **1,757.1 USD**, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve**

## **C. SHPENZIME DHE TË ARDHURA JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT.**

### **Rekomandim 1**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga preventivi përkatës i parashikuar për realizimin e punimeve në Usekun e Mulletit vlerën **2,434,309 USD**, vlerë e cila përfaqëson shtesë transporti, realizim vizatimesh dhe monitorimi gjeoteknik, parashikuar në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Menjëherë**

### **Rekomandim 2**

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga preventivi përkatës i parashikuar për realizimin e punimeve në Rrëshqitjen e Ibës vlerën **1,604,650 USD**, vlerë e cila përfaqëson shtesë transporti, realizim vizatimesh dhe monitorimi gjeoteknik, parashikuar në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

**Menjëherë**

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

## **Rekomandim 1**

Bazuar në Udhëzuesin për Konsulencë, sipas financimeve të Bankës Islamike për Zhvillim pika 1.d dhe 1.17, i kërkojmë Autoritetit Rrugor Shqiptar:

Të shpallë të papranueshëm për lidhjen e kontratave për shërbime konsulence Shoqërinë [REDAKTUAR] dhe për punime civile kompanitë [REDAKTUAR] si dhe të marrë masa për njoftimin e Bankës Islamike për Zhvillim mbi performancën e dobët të këtyre kompanive gjatë zbatimit të kontratave të ndërtimit të segmenteve rrugorë “Sauk – Tuneli i Krrabës” dhe “Tuneli i Krrabës-Elbasan”, për arsye se zbatimi i kontratës së supervizionit dhe zbatimi i kontratave të punimeve civile, është shoqëruar me shkelje dhe mangësi.

Nga KLSH me shkresën nr. 508/10, datë 11.11.2016 ” Mbi një ndryshim në rekomandimet e auditimit të përcjella me shkresën nr.508/7, datë 07.09.2016, referuar argumentimit, dokumentacionit, të paraqitur nga kompania [REDAKTUAR] bashkëlidhur ankesës nr.508/9, datë 14.10.2016, duke i qëndruar çdo konstatimi të auditimit në lidhje me shkeljet dhe mangësitë e evidentuara gjatë zbatimit të kontratave të supervizionit, **rekomandon** “pezullimin e përkohshëm të zbatimit të rekomandimit”, për këtë kompani , duke marrë në konsideratë të drejtën e saj për rregullimin të çdo parregullsie dhe mangësie të konstatuar, deri në përfundim të kontratës.

## **E. MASA DISIPLINORE**

Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar janë realizuar 100 % masat disiplinore.

## **2. AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL (AAC)**

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 1.04.2014 deri më 30.04.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 78, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 190/8, datë 30.06.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti i Aviacionit Civil , nuk ka kthyer përgjigje në KLSH për marrjen në konsideratë apo jo të rekomandimeve të lëna nga KLSH si dhe nuk ka miratuar planin e veprimit për masat e mara për realizimin e tyre, brenda afatit të 20 ditëve nga data e dërgimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15 shkronja “ j” të ligjit të Ligjit 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”.

- AAC nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor. Sqarojmë se momentin e mbajtjes së këtij Raporti Auditimi, AAC është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 25 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 22 dhe nga këto masa nuk janë zbatuar 9, janë në proces 5, janë zbatuar pjesërisht 2 dhe janë zbatuar plotësisht 6 rekomandime për masa organizative. Tre (3) masa organizative nuk janë pranuar.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime në vlerën 2,865,446 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6, nga të pranuarat, janë në proces 4 rekomandime, 1 rekomandim është zbatuar plotësisht dhe 1 rekomandim nuk është zbatuar. Nga shuma prej 2,865,446 lekë lënë detyrim për shpërblim dëmi, është arkëtuar shuma prej 241,599 lekë, më pak se 10 % e totalit.

- c. Janë rekomanduar sipas Statusit të Nëpunësit Civil 4 masa disiplinore, kompetencë e AAC ku prej të cilave 2 masa nuk janë pranuar (janë rrëzuar nga Komisioni i Disiplinës) dhe 2 të tjera nuk janë zbatuar. Gjithashtu janë propozuar 11 masa disiplinore kompetencë e APP e cila ja ka lënë në kompetencë titullarit fillimin e procedurave disiplinore. Për 13 masat gjithsej dhënë titullarit për kompetencë, nga AAC deri në momentin e hartimit të Raportit të Auditimit për zbatimin e rekomandimeve, nuk u paraqit vendimmarrje.

Në përfundim rikërkojmë Autoritetit të Aviacionit Civil përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 190/8, datë 30.06.2016, mbi auditimin me objekt "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

##### **Rekomandim 1**

-Nga AAC të merren masat për ndjekjen dhe realizimin e plotë të rekomandime të përcaktuara plotësisht, të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën nr.1073/7, datë 31.03.2014.

*Menjëherë*

##### **Rekomandim 3**

-Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të mos kryhen propozime dhe vendimmarrje në lidhje me financimin apo sponsorizimit e institucioneve të tjera shtetërore apo private, në kundërshtim me kompetencat e përcaktuara në ligjin për AAC dhe aktet e tjera në fuqi. Veprimtaritë e financuara jashtë funksioneve ligjore të AAC i ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe të shpërblimit të efekteve financiare.

*Menjëherë*

##### **Rekomandim 4**

1-Nga AAC të merren masa që të ndërpritet rimbursimi i shumave për punonjësit e AAC dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të cilat bien në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010. Procesi i rimbursimit për kategoritë përfutuese (Ia dhe Ib) të bëhet deri në limitet e përcaktuara në vendimin e mësipërm.

*Menjëherë*

2-Të bëhet ndryshimi i përgjegjësisë në pagesat e faturave për periudhën në vazhdim, nga AAC tek punonjësit e saj, kundrejt dakortësisë së punonjësve për marrjen e shërbimit me paketat përfutuese aktuale, apo të kërkuara për shërbimin përkatës, meqenëse AAC si institucion ka lidhur kontratë me kompaninë [REDAKTUAR] me periudhë të shkurtër kohore, ku aktualisht paraqitet mundësia e këtyre ndryshimeve.

*Menjëherë*

4-Nga Drejtoria Ekonomike e AAC në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, të realizohet hyrja në magazinë e celularëve të përfituar falas nga lidhja e kontratës me Kompaninë [REDAKTUAR] për pagimin e faturave të shërbimit për vitet 2014 dhe 2015 nga AAC dhe të kryhet kontabilizimi i shumës 2,014,900 lekë, vlerë e aparateve celulare të dhuruara, konform përcaktimeve në kontratë dhe amendamenteve të saj. Dhënia në përdorim e celularëve të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e mësipërm.

*Menjëherë*

##### **Rekomandimi 6.**

1-Të rishikohet dhe të miratohet nga Këshilli Drejtues rregullorja për veprimtarinë e tij, pasi rregullorja ekzistuese është e vitit 2010, duke përcaktuar në këtë rregullore emërimin e sekretares të këtij këshilli dhe detyrat e saj.

2-Vendimet e Këshillit Drejtues, të merren duke pasur relacione të sakta nga administrata e autoritetit dhe bazë ligjore të plotë për zbatimin e tyre, si dhe baza ligjore të pasqyrohet me saktësi dhe gjithëpërfshirëse në këto vendime.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 7.**

-Nga Drejtori Ekzekutiv në zbatim të akteve ligjore në fuqi për kompetencat e miratimit të strukturës organizative të AAC dhe Aeroportit të Kukësit të ndiqen të gjithë procedurat për paraqitjen dhe miratimin e nevojave për ndryshime të nevojshme strukturore, sipas kompetencave dhe miratimeve të përcaktuara në ligjin për AAC dhe aktet e tjera në fuqi.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 8.**

1-Nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Administratës dhe e Shërbimeve të merren masat që në bashkëpunim dhe sipas dakortësisë me DAP –in, të përfundojnë procesin e vlerësimit të dosjeve të punonjësve të AAC dhe përputhshmërinë me kërkesat e vendit të punës, për pasojë konfirmimin ose jo të statusit të nëpunësit civil.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e pozicioneve të punës në AAC për vetë procesin dhe funksionet që kryen AAC, në zbatim të ligjit për Kodin Ajror në Republikën e Shqipërisë si dhe nevojën e vazhdueshme të punonjësve të saj për të qenë të trajnuar periodikisht, konform standardeve ndërkombëtare dhe për të arritur kredencialet e përcaktuara në aktet dhe urdhrat në fuqi sipas kërkesave të vendit të punës, nga dy institucionet të hartohet një plan veprimi konkret për përfundimin e këtij procesi brenda afateve kohore sa më të afërta të vitit 2016. Përfundimi i këtij procesi i hap rrugën shpalljes dhe plotësimit të vendeve vakant aktuale dhe të mundshëm, të krijuar nga procesi i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil.

2-Të ngrihet grupi i punës për hartimin dhe miratimin e ndryshimeve të rregullores së brendshme të funksionimit të AAC në zbatim të strukturës aktuale të miratuar në fuqi.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 9**

1-Nga AAC referuar kompetencave ligjore për miratim, parashikuar në nenin 8 të ligjit të ndryshuar të AAC, brenda mundësive të financimit dhe hapësirave të kufijve minimal dhe maksimal të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për pagat e punonjësve të Institucionit, të krijohet fondi për financimin e “ pensionit profesional” si dhe përqindja e pjesëmarrjes së financimit nga institucioni në këtë pension profesional, duke marrë miratimet përkatëse sipas kompetencave ligjore.

2-Këto pagesa të kryhen nga AAC vetëm pas miratimeve përkatëse konform kërkesave ligjore dhe të trajtohen si të ardhura të punonjësve duke derdhur për to tatimin mbi të ardhurat në rastet e tejkalimit të kufijve të vendosur në nenin 88/4 dhe 88/5 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009” Për fondet e pensioneve vullnetare” .

3-Nga AAC, për pagesat për pension profesional prej 7,532,543 lekë për vitin 2014, dhe 12,700,563 lekë për vitin 2015, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat dhe derdhjes së tyre sipas procedurave të miratuara, për financimet e realizuara sa më sipër, të kryen llogaritjet për punonjësit e AAC, referuar tejkalimit të kufijve të vendosur në nenet 88/4 dhe 88/5 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009.

*Vazhdimisht*

#### **Rekomandim 10.**



1-Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë masa për aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare për mbajtjen e llogarive dhe Raportimit Financiar (IAS/IFRS), duke bërë dhe unifikimin me Albcontroll-sha.

2-Drejtoria Ekonomike duhet të bëjë propozimet përkatëse për miratim në KD në drejtim të miratimit të normave të amortizimit konform standardeve IAS/IFRS, të cilat specifikohen në mënyrë konkrete në udhëzuesin e Eurokontroll-it cituar mësipër, si dhe të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së tyre, duke përfshirë dhe të gjitha parashikimet e tjera në lidhje me koston në këtë udhëzues.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 11**

-Nga AAC pas miratimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2015 nga Këshilli Drejtues të realizohet derdhja në Buxhetin e Shtetit e shumave të papërdorura të konsoliduara në fund të vitit 2015, duke zbritur shpenzimet e angazhuara për tremujorin e parë të vitit 2016, konform përcaktimit në ligjin për AAC.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 12**

1-Drejtoria Ekonomike të marrë masat për përditësimin e regjistrit kontabël në zbatim të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.  
2-Nga Titullari i AAC të autorizohet vlerësimi i aktiveve të marra si donacion në aeroportin e Kukësit, në përputhje me parashikimet dhe procedurat e akteve ligjore në fuqi.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 21.**

-Të merren masa nga Titullari i AAC-së për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuar për çdo rast të blerjes apo shërbimit të kryer me procedurë prokurimi me vlerë të vogël, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 23.**

Nga Nëpunësi Autorizues dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në AAC nëpunësi autorizues është dhe Titullari i institucionit, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të ligjit të MFK.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 24.**

1-Nga AAC të krijohet regjistri i riskut institucional dhe referuar risqeve të mundshme të hartohet dhe miratohet sipas kompetencave strategjia e riskut me qëllim realizimin e objektivave institucionale vjetore e afatmesëm.

2-Nga titullari i institucionit të përcaktohen procedura të brendshme anti korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive konform kuadrit ligjor në fuqi.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 25**

- Nga AAC për rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së shërbimit të ruajtjes fizike të ambienteve në administrim të saj, të përcaktojë rregulla të brendshme strikte për mbikëqyrjen e këtij shërbimi, ku nga punonjësit përgjegjës të mbikëqyrjes për efekt të transparencës dhe auditimit të dokumentohen gjurmët e kësaj mbikëqyrjeje.

-Nga strukturat përkatëse të AAC të intensifikohen auditimet në Aeroportin ■■■ në drejtim të mbikëqyrjes së sigurisë së transportit ajror dhe marrjes së masave në përputhje me përcaktimet në Kodin Ajror të RSH.

*Menjëherë*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim 1**

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil në rastin e mungesës së aseteve telefonë celularë të markave dhe vlerave të përcaktuara në kontratën e lidhur me kompaninë [REDAKTUAR] dhe amendamenteve të saj,(pra me pamundësi bërje hyrje në institucion) të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet për arkëtimin e shumës **2,014,900 lekë** sipas përgjegjësive dhe përcaktimeve në kontratën e lidhur.

**Menjëherë**

### **Rekomandim 2.**

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës së shpërblimit të marrë nga kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues me vlerë gjithsej **472,600 lekë (590,750 lekë- 118,150 lekë arkëtuara)**, nga personat përfitues, sipas përcaktimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

### **Rekomandim 4.**

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës prej **242.5 Euro** nga personi përgjegjës z.F.G.

**Menjëherë**

### **Rekomandimi 6**

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës gjithsej **27,397 lekë**, nga të cilat **24,157 lekë** shoqëria [REDAKTUAR], përfituar padrejtësisht nga kontrata shtesë për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC, për nevojat e fillim vitit dhe shumës **3,240 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR], përfituar padrejtësisht nga kontrata e datës 03.03.2014 për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC.

**Menjëherë**

## **C. MASA DISIPLINORE**

**Rekomandimi C1.** Mbështetur në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AAC të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masës disiplinore sipas VKM nr.115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil":

**-“ Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 6 mujore ” neni 58, germa b** në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në AAC për:

**1. z. F. G** me detyrë Nëpunës Zbatues i AAC për arsye se:

**-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” neni 58, germa c, për :**

**2.z. F. B** me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv i AAC

**Rekomandimi C2.** Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin

civil", si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikes në administratën publike", i rekomandojmë Titullarit të AAC të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**"Vërejtje" neni 58, germa a për:**

**I.z. A. K** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve

**Rekomandimi C3.** Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikes në administratën publike", i rekomandojmë Eprorit direkt të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**"Vërejtje" neni 58, germa a për:**

**I.znj. E. Sh** me detyrë specialiste në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve

**Rekomandimi C4** Gjithashtu Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 190/9 datë 30.06.2016 për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik në AAC i ka paraqitur Agjencisë së Prokurimit Publik si organ kompetent, mangësitë dhe të drejtën për propozime për masa disiplinore apo administrative

**-Nga Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. 8533, date 17.11.2016 "Dërgim Vendimi "** drejtuar Autoritetit të Aviacionit Civil , për dijeni dhe KLSH , paraqitet vendimi nr.97, datë 17.11.2016 " Shqyrtim Raport Auditimi " ku APP në mbështetje të nenit 13, pika 2/i dhe nenit 72,pika 2 të LPP, në fuqi në kohën e kryerjes së procedurave të audituara, ka vendosur:

1. T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore, për shkeljet e konstatuara në këtë vendim , ndaj personave të poshtëshënuar , në cilësinë e anëtarëve të NJP në procedurat e audituara , konkretisht: **Znj. A.Gj, Z. Y.S , Z.K. S dhe znj.A. S.**
2. T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore, për shkeljet e konstatuara në këtë vendim , ndaj personave të poshtëshënuar , në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurat e audituara , konkretisht: **Z.P. H, Z. F. K, Znj.D.O, Z.R.A, Z.E. H, Z.E. K dhe Znj. I. P.**
3. Në respektim të nenit 66/2 të LPP, autoriteti kontraktor ka detyrim t'u njoftojë vendimin e dhënë nga APP, personave përgjegjës dhe të dokumentojë njoftimin.

#### Zbatimi i Rekomandimit

Sa mësipër nga AAC në drejtim të zbatimit të masave disiplinore të përcaktuara nga APP (kompetencë e saj) për 11 punonjës në referencë të shkeljeve të konstatuara nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk është dhënë asnjë informacion deri në momentin e hartimit të këtij Raporti Përfundimtar. **Rekomandimi nuk është zbatuar .**

### **3. UJSJELLËS KANALIZIME SHA TIRANË**

Nga auditimi i ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Tiranë -sha për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare" për periudhën 1.01.2014 deri më 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 80, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 253/13, datë 06.07.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ujësjellës Kanalizime Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën 16248, datë 25.07.2016 "Mbi programin e punës për zbatimin e Rekomandimeve të vendosura me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet me shkresën nr.253/13, datë 06.07.2016, brenda afatit të 20 ditëve në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj. Referuar zbatimit të rekomandimeve, Drejtori i

Përgjithshëm i UKT ka nxjerrë urdhrin nr.513, datë 19.07.2016 “Mbi miratimin e programit për zbatimin e rekomandimeve të lëna” nga KLSH me shkresën nr. 253/13, datë 06.07.2016. Ky program është vendosur bashkëlidhur shkresës së kthimit të përgjigjes dhe ka të përcaktuar drejtoritë përgjegjëse si dhe afatet e realizimit.

*-UKT nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor dhe në momentin e mbajtjes së këtij Raporti Auditimi, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 21. Këto masa, janë realizuar 13, në proces 8 rekomandime.*

*b. Për shpërblim dëmi janë lënë 10 rekomandime në vlerën 10,193 mijë lekë lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht 7 në vlerën 4,023 mijë lekë. Nga masat e rekomanduara janë në proces 4 dhe janë të pa zbatuara 6 rekomandime. Nuk ka arkëtime*

*c. “Të ardhura të munguara” dhe “Shpenzime dhe të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit” janë propozuar 3 masa dhe janë në proces 3. Janë arkëtuar detyrime të subjekteve deri në Tetor të vitit 2016 shuma 880,532,817.5 lekë nga 3,864,373,169.9 lekë që janë detyrimet në pasqyrat financiare*

*d. Janë rekomanduar 12 masa disiplinore bazuar në Kodin e Punës, gjendja e të cilave paraqitet;*

*- “Vërejtje deri në largim nga puna 7 masa dhe janë zbatuar me masë “vërejtje” 7.*

*- Janë rekomanduar nga KLSH 5 masa “Largim nga detyra” ku zbatimi paraqitet : 3 masa realizuar plotësisht dhe 2 masa realizuar pjesërisht ku nga largim nga detyra është dhënë masa “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.*

Në përfundim rikërkojmë Ujësjiellës Kanalizime – sha Tiranë përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 253/13, datë 6.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

### **Rekomandimi 11**

*UKT sh.a të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat si dhe të hartojë plan-veprimet afat shkurtra për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Në kuadër të zbatueshmërisë së ligjit të organizohen trajnime dhe seminare për të gjithë stafin me qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të këtij ligji në praktikë.*

**Menjëherë**

## **B. 1-MASA SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandimi 1**

*-Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 4,254,990 lekë të shkaktuar buxhetit të shtetit nga përlllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës duke sjellë një rritje fiktive të fondit limit nga z.*

*N. Gj me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm, znj. M. B me detyrë Drejtore e Prokurimeve, znj. K.H, znj. Th.K dhe znj. B. Xh në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 2**

*-Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 1,181,273 lekë të shkaktuar Shoqërisë nga skualifikimi me të padrejtë dhe kualifikimi i operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion, nga z. R. M, znj. E. I, znj. M. B dhe z. F. M në cilësinë e anëtarëve të KVO.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 3**

*-UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 1,331,064 lekë nga Kontraktori [REDAKTUAR], si penalizim për dorëzim të vonuar të furnizimit.*

**Menjëherë**

**Rekomandim 4.**

*-UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 672,450 lekë nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) [REDAKTUAR], për punime të likuiduara, por të pa realizuara.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 5.**

*-UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 668,433 lekë nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) [REDAKTUAR], për punime të likuiduara, por të pa realizuara.*

**Menjëherë**

**Rekomandim 6.**

*-UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 546,148.8 lekë nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) [REDAKTUAR], për punime të likuiduara, por të pa realizuara.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 7.**

*-Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 733,500 lekë, të shkaktuar Shoqërisë nga skualifikimi me të padrejtë dhe kualifikimi i operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion, nga z. N. Gj, znj. E. B, znj. M. B dhe znj. N. V, në cilësinë e anëtarëve të KVO.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 8.**

*-Nga UKT sh.a, të analizohet sipas destinacionit dhe personit përfitues si dhe të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 717,331 lekë të shkaktuar buxhetit të shtetit nga marrja më tepër e karburantit, nga shoferët sipas përdorimit të automjeteve për secilën periudhë.*

**Menjëherë**

**Rekomandimi 9.**

-Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjyqimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën **435 Euro** të shkaktuar buxhetit të shtetit nga përfitimi i padrejtë i shpenzimeve për udhëtime e dieta për 6 punonjësit:

**Znj. V. S me vlerë 178.8 Euro; znj. A. Z 43.8 Euro; znj. E. Gj 92.4 Euro; z. N. Gj 56.2 Euro; z. E. M 68.8 Euro; z. A. S me vlerë 193 Euro.**

**Menjëherë**

#### **Rekomandimi 10**

Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjyqimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën **193 Euro** nga punonjësi z. **A. S.**

**Menjëherë**

#### **4. MINISTRI E PUNËVE TË BRENDSHME PËR PROJEKTIN “ MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I TOKËS”**

Nga auditimi i ushtruar në *Ministrinë e Punëve të Brendshme* për projektin “ *Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës*” për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 2008 deri më 2013 ( periudhë e zbatimit të projektit) trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 182, datë 31.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 805/18, datë 31.12.2015, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH për marrjen në konsideratë apo jo të rekomandimeve të lëna nga KLSH si dhe nuk ka miratuar planin e veprimit për masat e marra për realizimin e tyre, brenda afatit të 20 ditëve nga data e dërgimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15 shkronja “ j” të ligjit të Ligjit 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, por sqarojmë se me shkresën 6788/51 datë 14.01.2016 “ Mbi zbatimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit të projektit” Menaxhimi dhe Auditimi i Tokës “ ( LAMP) i është Drejtuar Kryetarëve të Bashkisë Berat, Elbasan, Kamëz, Shkodër, ku i kërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.805/18, datë 31.12.2015. Gjithashtu në shkresë citohet detyrimi i këtyre Bashkive për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit brenda datës 25.01.2016, ku njëkohësisht për përgjigjet e dhëna duhet të vihet në dijeni me shkresë dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Shkresa 6788/51 sa me sipër i është dërguar për dijeni dhe KLSH. Referuar përmbajtjes së shkresës nuk rezulton, të ketë plan veprimi për masat e marra në zbatim të rekomandimeve,

- MPB nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me parashikimin në Ligjin nr.154/2014, datë 27/11/2014.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **9 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar **9 rekomandime** dhe janë zbatuar plotësisht **8 dhe 1 rekomandim** është në proces.

b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **8 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht **8**, nga masat e rekomanduara janë në proces zbatimi **3 rekomandime**(janë në proces gjyqësor), **3**

rekomandime nuk janë zbatuar dhe 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht. Nga shuma prej 24,202,759 lekë lënë detyrim për shpërblim dëmi, nuk është arkëtuar asnjë shumë.

c. Janë rekomanduar sipas Kodit të Punës 3 rekomandime për 25 punonjës për fillimin e procedurave për masa disiplinore, kompetencë e Bashkive Elbasan, Berat, Kamëz, ku prej të cilave është realizuar 1 rekomandim për 4 punonjës për bashkinë Kamës. Për 2 rekomandime që i korrespondojnë 21 punonjësve të Bashkisë Elbasan (13 vetë) dhe Bashkisë Berat (8 vetë), masat disiplinore janë të pa zbatuara.

e. Është propozuar "masa administrative" 1 rekomandim (për një subjekt dhe një kolaudator) në Bashkinë Shkodër. Kjo masë ka rezultuar e zbatuar plotësisht.

Në përfundim rikërkojmë MPB dhe Bashkive përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 805/18, datë 31.12.2015 mbi auditimin me objekt "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, dhe informimin mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim 1**

-Ministria e Brendshme, të marri masa dhe ti kërkojë operatorit ekonomik [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 43,179 USD, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt "Blerja dhe instalimi i tabelave me emërtimet e bulevardëve, shesheve, parqeve, rrugëve, rrugicave në bashkitë e Beratit, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Fushë-Krujës, Gjirokastrës, Kamzës, Korçës, Krujës, Lushnjës, Shkodrës, Vlorës dhe Vorës".

*Menjëherë*

### **Rekomandim 4 (Kompetencë e Bashkisë Berat)**

- Bashkia Berat të marrë masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,440,798 lekë, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt "Ndërtimi i Tregut Industrial Berat". Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Berat, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 5 (Kompetencë e Bashkisë Berat)**

Bashkia Berat të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 37,824 lekë, të përfituar padrejtësisht për diferenca në zëra punimesh në tenderin me objekt "Ndërtimi i Rrugës Lidhëse të Tregut Industrial të Qytetit të Beratit". Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Berat, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 6 (Kompetencë e Bashkisë Elbasan)**

Bashkia Elbasan të marrë masat që të kërkojnë nga personat përgjegjës, Titullari i Autoritetit Kontraktor z.Q. S, njësia e prokurimit e përbërë nga z.S. B, znj.B.L, z.E.S, z.O. K, znj.A. B dhe komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z.S. P, z.K. Xh, znj.M. B, znj.E. K dhe z.B.K, vlerën e dëmit ekonomik të shkaktuar në shumën 3,188,639 lekë. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Elbasan, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

*Menjëherë*

**Rekomandim 7 ( Kompetencë e Bashkisë Elbasan)**

*-Bashkia Elbasan që ti kërkojë operatorit ekonomik [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 3,647,181 lekë, të përfituar padrejtësisht si vlerë që i përket diferencave në zëra punimesh në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit”, për buxhetin e Bashkisë Elbasan në masën 30%, për buxhetin e pushtetit qendror në masën 20% dhe për Ministrinë e Brendshme në masën 50%.*

*Menjëherë*

**C. MASA DISIPLINORE.**

**Rekomandim I. ( Kompetencë e Bashkisë Elbasan)**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarrë masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për 13 punonjes:

1. S. B
2. B. L
3. E. S
4. O. K
5. A. B
6. S. P
7. K. Xh
8. M. B
9. E. K
10. B. K
11. J. R
12. G. P
13. B. M

*Menjëherë*

**Rekomandim 2 ( Kompetencë e Bashkisë Berat)**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Berat, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarrë masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për 8 punonjës:

1. M. K, me detyrë Drejtore Juridike e Bashkisë Berat (Për fazën e Projektit)
2. R. K
3. T. H
4. E. K
5. V. Z
6. I. K
7. F. Sh
8. L. Sh

*Menjëherë*

**5. SPITALI RAJONAL FIER**

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal Fier për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2013 deri 31.03.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 127, datë 30.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 350/15, datë 05.10.2016 dhe shkresën nr.350/28, datë 26.12.2016 “ Raport Përfundimtar Auditimi “Mbi kontrollin e cilësisë të ushtruar në Spitalin Rajonal Fier në bazë të urdhrin të



Kryetarit të KLSH-së me nr.128,datë 20.10.2016”, e cila ka dalë në zbatim të vendimit nr.155,datë 23.12.2016 të Kryetarit të KLSH-së, që ka miratuar “ Raportin e kontrollit të cilësisë të ushtruar në Spitalin Rajonal Fier dhe rekomandimet përkatëse”, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Rajonal Fier , *ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr.2611, datë 31.10.2016* “ Dërgim i programit të punës dhe vendimit për evadimin e materialeve të kontrollit” të dërguara me shkresën nr.350/15, datë 05.10.2016, *brenda afatit të 20 ditëve në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj*. Referuar zbatimit të rekomandimeve, Drejtore e Spitalit Rajonal Fier, ka miratuar programin e punës nr.1846, datë 28.10.2016 “ Për evadimin e materialeve të KLSH të ushtruar në SRF “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimeve financiare të SRF” për periudhën 1.01.2013 deri më 31.03.2016. Ky program është vendosur bashkëlidhur shkresës së kthimit të përgjigjes dhe ka të përcaktuar drejtoritë përgjegjëse si dhe afatet e realizimit.

-SRF nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor *dhe në momentin e mbajtjes së këtij Raporti Auditimi, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*,

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 18 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 18 dhe nga këto masa, janë në proces 18 rekomandime.

b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë 10 rekomandime në vlerën 15,076,879 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 10, nga të pranuarat, janë në proces 10 rekomandime.

c. Janë rekomanduara sipas **Kodit të Punës 7 masa disiplinore**, “Zgjidhje të kontratës së punësimit” ose “Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate” prej të cilave janë zbatuar 7 masa disiplinore “Vërejte me paralajmërim për pushim nga puna”. Me shkresën nr.350, datë 26.12.2016 është shtuar 1 masë disiplinore e cila aktualisht është e pa zbatuar.

Pra rekomandime për masa disiplinore gjithsej 8 dhe zbatuar 7, 1 masë disiplinore e pazbatuar.

Në përfundim rikërkojmë Spitalit Rajonal Fier përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 315/15, datë 5.10.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, ose në proces, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **A.MASA ORGANIZATIVE**

### **I. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.**

#### Rekomandim i lënë

##### **Rekomandim 1**

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 945/6, datë 12.06.2007.

*Menjëherë*

### **II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.**

#### **Rekomandim 2**

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masa për rrethimin e jashtëm të 4 godinave ku të bëhet ndarja e objekteve të spitalit me rrugët dhe me godinat private përreth.

*Në vazhdimësi*

### **III. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.**

#### **Rekomandim 1**

Nga Drejtori i Spitalit dhe Zyra e Financës, të përmirësohet puna në drejtim të një komunikimi më të mirë midis strukturave të përfshira në sistemin spitalor, duke dhënë informacionin e nevojshëm në kohën e duhur, bashkërendim i punëve, veprim i cili do të ndihmojë në marrjen e masave të duhura për të parandaluar situata të vështira në likuidim të faturave të prapambetura.

*Menjëherë*

### **V. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të Spitalit Rajonal Fier.**

#### **Rekomandim 1**

-Nga Drejtori i Spitalit dhe Zyra Juridike, të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqësorit deri në Gjykatën e Lartë, për të gjitha proceset gjyqësore ku, është palë Spitali Rajonal Fier dhe të dalin personat përgjegjës që nuk e kanë ndjekur procedurën e ankimit deri në Gjykatën e Lartë dhe të merret masë disiplinore, si dhe të shqyrtohet efekti financiar në vlerën **6,161,505 lekë**, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.

*Në vazhdimësi*

#### **Rekomandim 2**

Nga Drejtoria e Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori i Planit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me konsumin e karburantit të mjeteve dhe kaldajave, si dhe hapjen e plotësimin e kartelave përkatëse për çdo mjet, duke rritur kërkesat për një sistem më të saktë monitorimi dhe kontrolli lidhur me këto shpenzime.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 3.**

Nga Drejtori i Spitalit Rajonal Fier të merren masa për shqyrtimin e **efektit financiar negativ** në vlerën **643,652 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore për kthimin tollonave të benzinës në sasinë 3,360 litra, të cilëve u ka kaluar afati i përdorimit.

*Menjëherë*

### **VI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.**

#### **Rekomandim 1**

-Për çdo rast, përdorimi i procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, duhet të dokumentohet dhe të argumentohet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në procedurat e prokurimit: “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, që do të realizohen në zbatim të nenin 33 të ligjit të sipërcituar të mbahet dokumentacion për argumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik që do t’u dërgohet ftesa për ofertë dhe për negociimin e çmimeve të ofertës me operatorin fitues.

-Autoriteti Kontraktor në çdo procedurë prokurimi që do të realizojë, të argumentojë hartimin e kërkesave për kualifikim, përcaktimi dhe vendosja e tyre të bëhet në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet.

#### **Rekomandimi 2**

Autoriteti Kontraktor në çdo procedurë prokurimi që do të realizojë, të marrë masa që:

-ftesat për negociim të jenë të nënshkruara nga marrësit e ftesës dhe operatorët ekonomik të

njoftohen për fituesin e tenderit, sipas LPP, nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 21 pika 2 dhe neni 22 pika 1.

-të argumentohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, neni 61.

-të merren masa që specifikimet teknike të bëhen konform standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu III, neni 23, pika 3.

-të argumentohet përlllogaritja e fondit limit, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, neni 59.

-të bëhet planifikimi i nevojave nga sektorët përkatës të institucionit, bazuar në ligjin nr. 10 296, datë 08.7.2010, “Për menaxhimin financiar” neni 4, pika 26.

-të argumentohet mënyra e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike të ftuar, sipas nenit 33, pika 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-të respektohet pasqyrimi i të dhënave nga DST, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VII, neni 61.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 3**

-Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike:

Autoriteti Kontraktor, duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Nga titullari i AK t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të tyre, pasi në disa raste nuk janë korrekte.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e anuluar, nga Autoriteti Kontraktor të analizohen shkaqet dhe të nxirren përgjegjësitë, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet të komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

*Menjëherë*

## **VII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël.**

### **Rekomandim 1**

**Për sa më sipër rekomandojmë:** Nga Spitali Rajonal Fier të merren masa që:

-Të dërgohet në APP regjistri i parashikimeve të blerjeve me vlera të vogla, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4.

-Për të njëjtin grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbim apo pune, të realizohet një procedurë, me qëllim shmangien e përdorimit të procedurave elektronike në kundërshtim me kreun II, neni 8, pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në çdo fillim viti të hartohen kërkesat vjetore për mallra dhe shërbime nga sektorët e Spitalit Rajonal Fier, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”.

-Të protokollohen dhe arkivohen dosjet për blerjet e vogla, sipas kreut II të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

## **VIII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.**

### **Rekomandimi 1**

-Nga Drejtorja e Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik, të merren masat që për ambientet e dhëna me qira, pas miratimit paraprak të Ministrit të Shëndetësisë, të lidhen kontratat përkatëse dhe të pajisen me matës të energjisë elektrike, ujit, si dhe të ndiqet arkëtimi në kohë i këtyre detyrimeve.

*Menjëherë*

## **IX. Auditim mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

### **Rekomandim 1**

-Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura, që në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi autorizues në ministri, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetor për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësin e vetëvlerësimit. Të hartojë dhe miratojë Kodin Etik, rregullore apo udhëzime për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Spitali Rajonal Fier, të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

-Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

-Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, Spitali Rajonal Fier, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, të hartojë programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ka funksionuar dobët në këtë njësi. Gjithashtu, të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

-Spitali Rajonal Fier të marrë masa, në bashkëpunim me FSDKSH, për përfundimin e instalimit të programit “Administrimi dhe Monitorimi i Shpenzimeve Spitalore”, nëpërmjet të cilit do të menaxhoheshin pothuajse të gjitha aktivitetet e spitalit, si farmacia, magazinat, blerjet dhe shpenzimet, shërbimi spitalor, etj., që do të bënte të mundur jo vetëm nxjerrjen në kohë dhe të saktë të dhënave, por edhe monitorimin e të gjithë shërbimeve të spitalit, si ato mjekësore dhe ato financiare, pasi deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi ky sistem konsiston vetëm në instalimin e një posti në sektorin e financës dhe të disa trajnimeve të punonjësve.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **X. Të ndryshme**

### **Rekomandim 1**

Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura, që në të ardhmen për përlogaritjen e sasisë që do të prokurohet për medikamente, kite & reagonte e materiale mjekësore, të marrë në konsideratë gjendjen e medikamenteve në kohën e prokurimit, konsumin e viteve

paraardhëse, kohën e prodhimit e afatet kohore të skadencës dhe trendin që ka “malli” që do të prokurohet, në mënyrë që të minimizohet sasia e materialeve që rrezikohet të eliminohet si rezultat i planifikimit të pasaktë, që për periudhën e audituar u konstatua efekt financiar negativ 4,863,388 lekë.

*Në vazhdimësi*

## **Rekomandimi 2**

Titullari i AK të marrë masat që në të ardhmen Njësia e Prokurimit Publik të hartojë dhe të dërgojë në APP regjistrin e parashikimeve të prokurimit të fondeve publike, në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, për gjithë të ardhurat, në përputhje me formën dhe mënyrën, që parashikohet në udhëzimet e APP-së. Brenda afateve ligjore, titullari i autoritetit kontraktor të dërgojë, pas miratimit, një kopje të regjistrin të parashikimeve e realizimeve të prokurimit në institucionin qendror. Në rastet kur autoriteti kontraktor mund të ketë ndryshime në fondet që ka në dispozicion, të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike. Të dërgojë në APP-së ndryshimet e bëra që botohen, në formë elektronike, në Website-in e APP-së”.

Për sa i takon raportimit të realizimeve të prokurimit publik, AK, brenda afateve kohore të dorëzojë në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit. Institucion dërgojë APP-së një raport të prokurimeve të realizuara. Ky raport të tregojë edhe fondet shtesë, të krijuara apo transferuara, nga autoriteti kontraktor.

*Në vazhdimësi*

## **Rekomandim me shkresën e KLSH me nr. 350/28, datë 26.12.2016**

1. Nga Spitali Rajonal Fier të merren të gjitha masat në mënyrë që të gjitha kërkesat që do të kryhen për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, materiale konsumi si dhe nevojave për mirëmbajtje të jenë të argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, si dhe të merren të gjitha masat për organizimin e procedurave të tenderëve duke shmangur në maksimum procedurën ‘Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit’, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve si dhe urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

*Vazhdimisht*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

### **Rekomandimi 1**

-Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatorit ekonomik [REDAKTUAR], shpërblimin e dëmit në vlerën 9,617,400 lekë.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 2**

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 2,310,000 lekë nga operatori ekonomik [REDAKTUAR]

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 4**

-Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 912,640 lekë pa tvsh, nga E. D, V. J dhe A. B anëtarë të Njesisë së Prokurimit.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 5.**

Nga Drejtoria e Spitalit të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 1,014,872 lekë** nga bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë [REDACTED].

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 6**

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 835,200 lekë**, nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave **D. P, M. H dhe N. B.**

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 8.**

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 131,400 lekë** nga Personi Fizik **F. B.**

*Menjëherë*

#### **Rekomandim 9**

-Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar personave përgjegjës (anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2013: **M. H, E. D dhe E. M**), shpërblimin e **dëmit në vlerën 111,168 lekë**, sipas gjetjeve të mësipërme dhe të arkëtohen në sektorin e financës të Spitalit Rajonal Fier.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 10**

-Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar personave përgjegjës (anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2014-2015: **M. H, E. D dhe R. M**, shpërblimin e **dëmit në vlerën 75,640 lekë**, sipas gjetjeve të mësipërme dhe të arkëtohen në sektorin e financës të Spitalit Rajonal Fier.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 11**

-Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 48,836 lekë**, nga përgjegjësja e Sektorit të Financës **M. H.**

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 12**

-Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 19,720 lekë**, nga përgjegjësja e Sektorit të Financës **M. H.**

*Menjëherë*

Masat disiplinore 7 masa janë realizuar plotësisht dhe janë të nivelit “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.

-Me shkresën nr. 350/28 datë 26.12.2016, shtohet një masë disiplinore “ Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” për **znj.E. Q** si anëtare e njësisë së prokurimit publik për shkeljet në procedurat e prokurimit publik, të cilat janë paraqitur me mangësi.

Në rekomandimet e vendosura sa mësipër janë përfshirë dhe rekomandimet e rezultuara nga Kontrolli i Cilësisë të miratuara me vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr.155, datë 23.12.2016 dhe dërguar me shkresën nr. 350/28 datë 26.12.2016.

### **6. SPITALI RAJONAL DURRËS**

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, administrimin e pronës shtetërore, prokurimin e fondeve publike vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2014, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 156, datë 04.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 107/21, datë 04.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Rajonal Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 2237, datë 28.12.2015, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Titullarit nr. 2146, datë 09.12.2015, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili brenda datës 16.12.2015 kishte për detyrë të raportonte për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Rajonal Durrës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore dhe nënligjore** është lënë **1** rekomandim, i cili nuk është zbatuar.
- b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **10 masa organizative**, nga të cilat janë realizuar plotësisht 8 rekomandime, pa realizuar 1 masë organizative dhe është në proces realizimi 1 rekomandim.
- c. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **18** rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 18, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 4 rekomandime dhe 14 rekomandime janë në proces realizimi.
- d. Janë rekomanduar **31 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;  
- **1 masë disiplinore nuk është pranuar dhe 30 masa janë realizuar plotësisht.**  
- Sipas **Kodit të Punës**, janë lënë 30 masa disiplinore e përkatësisht; “**Vërejtje**” 26 masa dhe “**Largim nga puna**” 4 masa, janë zbatuar..
- e. Janë rekomanduar **5 masa administrative**, nga të cilat pranë SRD nuk ka përgjigje nga APP.

Spitalit Rajonal Durrës i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 107/21, datë 04.12.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, administrimin e pronës shtetërore, prokurimin e fondeve publike vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim A.1.**

-Me grup pune të veçantë të studiohen të gjitha nevojat për blerje të vogla si për vitin 2014 dhe për vitin në vazhdim, mbi bazën e kërkesave të të gjitha pavioneve dhe administratës, të hartohet një bilanc duke përcaktuar gjendjen çdo muaj, konsumin mujor dhe ditor, në mënyrë që të hartohet një regjistër i blerjeve të vogla sa më real dhe mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

-SRD, për subjektet që lëshojnë faturat e thjeshta tatimore për shërbimet ose mallrat e ofruara, të marrë konfirmim për formën e tyre juridike në momentin e faturimit dhe të kërkojë shoqërimin e faturave me kuponin tatimor, me qëllim shmangien e efekteve negative fiskale.

**Menjëherë**

## **7. SPITALI RAJONAL VLORË**

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën nga data 01.01.2012 deri më datë 30.09.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 12, datë 12.02.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 962/12, datë 15.02.2016, konstatohet se:

Në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Rajonal Vlorë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, por nga institucioni brenda periudhës 19-25-28 shkurt 2016 ka hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe konkretisht: Për 14 masa organizative, dokumentet e njoftimit, janë të protokolluar me datat 19-25 Shkurt 2016. Për 30 masa dëmshpërblimi për të cilat janë bërë njoftimet përkatëse për çdo individ apo subjekt, për detyrimet e tyre ndaj institucionit. Dokumentat e njoftimit janë të protokolluar me datat 19-25 Shkurt 2016. Për 13 masa disiplinore për punonjësit aktualë në institucion për të cilët është zbardhur vërejtja dhe janë bërë njoftimet e individëve për masat disiplinore. Për 8 masa disiplinore për punonjësi e larguar nga puna për të cilët akoma nuk është kryer njoftimi. Dokumentet për zgjidhjen e rekomandimeve janë të protokolluar me datat 20-28 Shkurt 2016.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Rajonal Vlorë, me shkresën nr. 3416, datë 01.07.2016, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **14 masa organizative**, nga të cilat është realizuar plotësisht 7 rekomandime, pa realizuar 2 masë organizative, në proces realizimi 4 rekomandime dhe 1 masë pjesërisht e realizuar.
- b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **6 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 0 rekomandime, 2 rekomandime pa realizuar dhe 4 rekomandime pjesërisht të realizuar.
- c. Janë rekomanduar **13 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet; 13 masa disiplinore janë zbatuar, dhe 8 masa disiplinore konsiderohen të ezauruara sepse janë punonjës të larguar nga puna.  
-Sipas **Kodit të Punës**, janë lënë **13 masa disiplinore** e përkatësisht: “**Vërejtje me shkrim**” dhe janë zbatuar dhe 8 masa disiplinore për ish-punonjësit të cilat konsiderohen si masa të ezauruara.



Spitalit Rajonal Vlorë i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 962/12, datë 15.02.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim A.1.**

Të hartohet dhe miratohet rregullorja e re e institucionit në të cilën të përshkruhen me hollësi detyrat dhe përgjegjësitë për secilin punonjës.

Nga Titullari i institucionit dhe auditit i brendshëm të analizohet sistemi i kontrollit të brendshëm dhe të përcaktohen ato procedura dhe veprimtari që kanë nevojë për përmirësim, duke hartuar rregulla dhe procedura të reja për to.

Për operacionet më të rëndësishme që kryen në institucion, të hartohet lista me proceset kryesore të punë dhe të përshkruhet me hollësi kyerja e procesit, si dhe të përgatitet gjurma e auditimit.

Të hartohet rregjistri i riskut nga secil nivel kryesor menaxherial, ku të përcaktohet efekti negativ, shkalla e mundësisë së ndodhjes së ngjarjes, si dhe personat përgjegjës për adresimin e riskut.

Të përcaktohen rregulla të brendshme konkrete për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të institucionit.

Të plotësohet çdo fillim viti nga Titullari raporti vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

*Menjëherë*

### **Rekomandim A.2.**

Nga Titullari i SR Vlorë, të merren masa për të eliminuar pjesëmarrjen e anëtarëve të KVO-së në grupet e punës për përcaktimin e fondit limit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave të përfshihen specialistë të fushave përkatëse e veçanërisht në tenderat për blerjen e medikamenteve.

*Menjëherë*

### **Rekomandim A.4**

Nga Titullari i institucionit dhe zyra juridike, të merren masa që në rastin e lidhjes së kontratave për dhënien e objekteve me qira, të kërkohet nga qiramarrësi kryerja e pagesës së garancisë së kontratës përpara nënshkrimit të saj.

*Në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim B.1**

Të merren masa nga Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore, që të kërkohet shlyerja e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ulja e tarifës së qirasë mujore, në vlerën 408,333 lekë nga **z. A. V** dhe në vlerën 703,667 lekë nga **z. A. A.** Gjatë lidhjes së kontratave për dhënien e objekteve me qira, të zbatohen tarifat e qirasë mujore që përcakton legjislacioni në fuqi.

*Menjëherë*

### **Rekomandim B.2**

Nga titullari i Institucionit të kërkohet duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 56,964 lekë nga **Z. S. D** dhe 61,291 lekë nga **Znj. A. T.** Në të ardhmen Drejtoria e spitalit Vlorë të mmarë masat që faturat për shpenzimet telefonike të paguhen brenda harkut kohor të përcaktuar nga [REDACTED].

*Menjëherë*

### **Rekomandim B.3**

Të merren masa nga Titullari i Spitalit Vlorë, që ti kërkojë operatorit ekonomik [REDACTED] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 321,833 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B.4**

Drejtoria e Spitalit Vlorë të marë masat që t'i mbajë Operatorit Ekonomik [REDACTED] shumën 76,346 lekë dhe Operatorit Ekonomik [REDACTED] shumën 34,334 lekë, si konfiskim i sigurimit të kontratës.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B.5**

Të merren masa nga Titullari i spitalit Vlorë, që ti kërkojë personave përgjegjës shpërblimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës për:

-398,358 lekë nga **A. I, Y. D, J. LI dhe K. D.**

-684,528 lekë nga hartuesi i preventivit **Z. G. D.**

-53,064 lekë nga **A. B, S. D, A. I, F. S dhe F. M.**

-49,988 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, **A. B, S. D, A.I, F. S dhe F. M.**

-282,120 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit **A. B, S. D, A. I, F. S.**

-58,000 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, **A. S, E. S, B. D dhe F. S.**

-96,000 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, **A. S, E. S, B. D dhe Y. K**

-76,300 lekë nga anëtarët e Njësinë së Prokurimit, **A. S, A. P, S. B dhe F. S.**

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B.6.**

Të merren masa nga Titullari i Spitalit Rajonal Vlorë, që t'i kërkojë operatorëve ekonomik shpërblimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës për:

-36,760 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga lëvrimi i karburantit me çmim të rritur. Sipas ekstraktit nga banka [REDACTED] datë

-14,260 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga lëvrimi i karburantit me çmim të rritur.

-63,080 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga lëvrimi i karburantit me çmim të rritur.

-50,760 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga lëvrimi i karburantit me çmim të rritur.

-32,784 lekë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] për dëmin ekonomik të shkaktuar nga lëvrimi i lendes djegëse, me çmim të rritur.

*Menjëherë*

### **8. UJËSJELLËS KANALIZIME SHA DURRËS**

Nga auditimi i ushtruar në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën nga data 01.05.2014 deri më datë 31.12.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 27, datë 31.03.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1209/11, datë 31.03.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjellës Kanalizime” SHA Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1299, datë 06.05.2016. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë ka dërguar informacion mbi zbatimin e masave disiplinore dhe masave për shpërblim dëmi. Konkretisht është cilësuar se janë vendosur masat disiplinore të përmendura

në raportin e auditimit, si dhe janë dërguar njoftime për shpërblim dëmi, sipas masave për shpërblim dëmi të cilësuar në raportin e auditimit. Në lidhje me masat organizative nuk është shprehur në lidhje me statusin e zbatimit të tyre. Shkresa e UKD është dërguar në KLSH, në tejkallim të afatit 20 ditor, të përcaktuar në shkresën nr. 1209/11, datë 31.03.2016, protokolluar në UKD me nr. 513/22, datë 04.04.2016 “Raporti Përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet”, si dhe nuk është njoftuar KLSH për programet për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15, germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Durrës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7 masa organizative**, nga të cilat nuk janë realizuar 2 rekomandime dhe janë në proces realizimi 5 rekomandime.
- b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **9 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, si dhe janë në proces realizimi 6 rekomandime.
- c. Janë rekomanduar **23 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë 23 masa disiplinore e përkatësisht; 14 masa disiplinore “**Paralajmërim për pushim nga puna**” nga të cilat 14 pranuar, nga të cilat 12 masa janë zbatuar plotësisht, ndërsa 2 masa janë zbatuar pjesërisht duke u kthyer në “Vërejtje”, si dhe janë rekomanduar 9 masa “**Vërejtje**”, nga të cilat 9 pranuar, të cilat 9 janë zbatuar plotësisht.

Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Durrës i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1209/11, datë 31.03.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim A.1**

Ujësjetllës-Kanalizime SHA Durrës të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara nga auditimi i mëparshëm.

*Në vazhdimësi*

### **Rekomandim A.2**

Ujësjetllës-Kanalizime SHA Durrës të marrë masa për rritjen e arkëtimeve të ujit të faturuar duke përfshirë edhe kamatëvonesat përkatëse, me synim rritjen e të ardhurave të shoqërisë.

*Vazhdimisht*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim B.1**

Ujësjetllës-Kanalizime SHA Durrës, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 7,710 lekë nga **z. G. D**, për pagesa në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011.

### **C. MASA DISIPLINORE**

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, rikërkojmë nga Administratori i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

**“Paralajmërim për pushim nga puna” për:**

**Rekomandim C.1. z. D. Gj,** në cilësinë e anëtarit të KVO.

**Rekomandim C.2. z. A. I,** në cilësinë e anëtarit të KVO.

### **9. UJËSJELLËS KANALIZIME SHA LEZHË**

Nga auditimi i ushtruar në shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Lezhë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, për periudhën nga data 01.01.2012 deri më datë 30.06.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 109, datë 20.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 631/6, datë 21.09.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Lezhë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 337, datë 11.10.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Titullarit nr. 31, datë 26.09.2016, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili brenda datës 26.09.2016 kishte për detyrë të raportonte për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Ujësjiellës Kanalizime” SHA Lezhë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, për arsye se nuk është plotësuar ky afat në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20 masa organizative**, nga të cilat është realizuar plotësisht 1 rekomandim dhe janë në proces realizimi 19 rekomandime.
- b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **5 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 5, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime.
- c. Janë rekomanduar **4 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë 4 masa disiplinore e përkatësisht; “**Vërejtje**” 4 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

Në përfundim, shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Lezhë, **nuk do i dërgohet shkresë për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 631/6, datë 21.09.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, për arsye se kjo shoqëri i ka pranuar dhe është në proces zbatimi për të gjitha masat organizative, i ka zbatuar plotësisht të gjitha masat për shpërblim dëmi dhe masat disiplinore.**

### **10. UJËSJELLËS KANALIZIME SHA POGRADEC (Auditimi i ligjshmërisë e rregullshmërisë)**

Nga auditimi i ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, për periudhën nga data 01.07.2009 deri më datë 31.08.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 175, datë 29.12.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 800/14, datë 29.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijëni, me shkresën nr. 37/2, datë 26.01.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuar. Me urdhrin e Titullarit nr. 27, datë 26.01.2016 “Për zbatimin e planit të veprimit”, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili kishte për detyrë të raportonte për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, por pa afat të përcaktuar.

Në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20 masa organizative**, nga të cilat është realizuar plotësisht 3 masa, janë në proces realizimi 9 masa, realizuar pjesërisht 4 masa dhe nuk janë realizuar 4 masa.
- b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **21** rekomandime, nga të cilat janë 11 masa nuk janë zbatuar dhe 10 masa nuk janë pranuar.
- c. Janë rekomanduar **4 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë 4 masa disiplinore e përkatësisht; 4 masa “Zgjidhje të kontratës së punësimit” ose “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, masat janë zbatuar pjesërisht.
- d. Për **4 punonjës që rezultonin të larguar nga puna**, për të cilët duhet të njoftohej Departamenti i Administratës Publike, **masa nuk është zbatuar**.

Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 800/14, datë 29.12.2015, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim A.1**

Nga sekretari i Asamblesë së Aksionerëve dhe Këshillit Mbikqyrës, të merren masa për protokollimin dhe noterizimin e vendimeve dhe procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarit, si dhe të merren masa për krijimin e një faqe WEB të shoqërisë, ku të bëhet dhe publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë.

***Brenda datës 31.03.2017 dhe Vazhdimisht***

### **Rekomandim A.2**

Nga Drejtoria i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i burimeve njerëzore, ti kushtohet vëmendje burimeve njerëzore, si faktor i rëndësishëm për kryerjen e një shërbimi cilësor për furnizimin me ujë të popullatës. Në këtë kontekst, të shikohet si përparësi vendosja e kriterëve në bazë të profesionalizimit në punësimin e stafit, si dhe plotësimi i dokumentacionit vërtetues për kualifikimet e tyre.

*Brenda datës 31.03.2017 dhe Vazhdimisht*

### **Rekomandim A.3**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për ndjekjen e procedurave ligjore dhe miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve në Asamblenë e Aksionarit, referuar Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

*Brenda datës 31.03.2017*

### **Rekomandim A.4**

Nga Drejtoria i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori i financës, të merren masat për paraqitjen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, të detyrimeve që rrjedhin nga kredia e Projektit “Mbrotjtja e Liqenit të Ohrit”, si dhe saktësimin e vlerës së aktiveve pas inventarizimit vjetor.

*Brenda datës 31.03.2017*

### **Rekomandim A.5**

Nisur nga mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit, nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria i Përgjithshëm i shoqërisë, të vlerësohen kapacitetet në prokurimin e fondeve publike dhe të planifikohen trajnime të vazhdueshme për të rritur nivelin profesional të punonjësve që merren me prokurimet, me synim rritjen e efektivitetit në prokurimet publike.

*Vazhdimisht*

### **Rekomandim A.6**

Nga Drejtoria i Përgjithshëm i shoqërisë dhe sektori juridik, të merren masa për lajmërimin e operatorit ekonomik [REDAKTUAR] për defektin e dhënë nga inverteri, si dhe të merren masa për zëvendësimin e kësaj pajisjeje nga kjo shoqëri, e në rast të kundërt të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës së inverterit nga kjo shoqëri.

*Brenda datës 31.01.2017*

### **Rekomandim A.7**

Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë efektin financiar negativ në vlerën **3,269,067.60 lekë**, të shkaktuar nga skualifikimi i padrejtë i ofertës së operatorit ekonomik me vlerë më të ulët në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.

*Brenda datës 31.01.2017*

### **Rekomandim A.8**

Nga Drejtoria i Përgjithshëm i shoqërisë, sektori i shitjes dhe sektori i financës, të merren masa për zbatimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 11.07.2006, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.12.2009, mbi tarifatat për lidhjet e reja që do aplikohen në të ardhmen, konform Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, duke eliminuar procedurat e shmangies nga pagesat e detyrimit të TVSH.

*Brenda datës 31.03.2017 dhe Vazhdimisht*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim B. 1**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **112,910 lekë** nga S. A, për pagat e përfituara pa u paraqitur në punë.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 2**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **464,580 lekë**, nga **R. T.** në vlerën **240,300 lekë** dhe nga **G. M** në vlerën **224,280 lekë**, për përfitimin e padrejtë të shpërblimit pa marrë pjesë për më shumë se 6 muaj rradhazi në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 3**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **49,413 lekë**, nga **B. C** në vlerën **16,853 lekë**, **F.Xh** në vlerën **18,726 lekë** dhe **L. P** në vlerën **13,833 lekë**, për shpërblimin e përfituar në vitin 2012, pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 4**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **193,380 lekë**, nga **J. Gj** për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 5**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **22,500 lekë**, nga **B. Gj** për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 6**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **108,000 lekë**, nga **A. T.** në vlerën **54,000 lekë** dhe **Ë. I.** në vlerën **54,000 lekë**, për shpërblimin e përfituar në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 7**

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të analizohet vlera **1,818,740 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerjen e 1030 copë matës uji, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Pogradec dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 8**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,510,870.56 lekë** nga operatori ekonomik [redacted] për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e mallrave në zbatim të kontratës pa numër protokollit të datës 27.01.2012, të nënshkruar midis palëve.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 9**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **81,600 lekë** nga operatori ekonomik [redacted], për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e mallrave në zbatim të kontratës pa numër protokollit të datës 25.07.2011, të nënshkruar midis palëve.

*Menjëherë*

**Rekomandim B. 10**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **243,949 lekë** nga operatori ekonomik [REDACTED] për dëmet e likuidueshme për vonesën në dorëzimin e projekt-zbatimit në zbatim të kontratës pa numër protokollit të datës 12.07.2010, të nënshkruar midis palëve.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 11**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **252,811 lekë** nga operatori ekonomik [REDACTED] për faturimin e kryer në kundërshtim me kontratën pa numër protokollit të datës 19.02.2010, të nënshkruar midis palëve.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 12**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **26,829 lekë** nga operatori ekonomik [REDACTED] për faturimin e kryer në kundërshtim me kontratën pa numër protokollit të datës 04.04.2011, të nënshkruar midis palëve.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 13**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **120,809 lekë**, nga **E. V** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015, për shpenzimet e servisit të makinës të kryer në Greqi, pa dokumentacion vërtetues në kundërshtim me udhëzimin nr. 1, datë 01.02.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 14**

Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të analizohet vlera **420,695 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerjen e 177 copë matës uji, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” SHA Pogradec dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 15**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **156,000 lekë**, nga **E. V** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe **E. M** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për riparim transformatori, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 16**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **162,000 lekë**, nga **E.V** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe **E. M** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për blerje sharra inoksi, pa dokumentacion vërtetues e shoqërues, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 17**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **30,000 lekë**, nga **E. V** me detyrë Drejtor i



Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe **L. M.** me detyrë Menaxher IT për periudhën objekt auditimi, për paradhënie për shërbim në Gjermani, të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 18**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 515,000 lekë**, nga E. V me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015 dhe E. M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e sistemit të faturimit, për të cilën nuk u paraqit dokumentacioni i nevojshëm si dhe aktmarrëveshja me kompaninë, që ka kryer shërbimin, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 19**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 91,666 lekë**, nga E. V me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i UK Pogradec për periudhën 22.05.2013-31.08.2015, për karburantin e tërhequr në muajin Qershor 2013, në kundërshtim me Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 20**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 91,100 lekë**, nga A. T me detyrë Përgjegjës i sektorit mekanik dhe inxhinier për prodhimin e ujit, për periudhën korrik 2009 – gusht 2015, për karburantin e tërhequr në muajin Tetor 2014, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **Rekomandim B. 21**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 409,116 lekë**, nga **M. C** me detyrë shofer i drejtorit të përgjithshëm, për karburantin e tërhequr të pa justifikuar me dokumentacion vërtetues (fletë-udhëtime) në periudhën Janar 2014 – Gusht 2015, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

### **C. MASA DISIPLINORE**

#### **Rekomandim C.1**

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese dhe ligjzbatuese, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore “Largim nga detyra” në vartësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. **E. V** me detyrë drejtor i shoqërisë për periudhën 22.05.2015-14.10.2015, shkarkuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës;
2. **E. M** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Brendshëm dhe Financës për periudhën objekt auditimi, dalë në pension;
3. **A. L**, në cilësinë e anëtares së komisionit të vlerësimit të ofertave për tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pajisje elektrike fuqie për nevojat e SHA”;
4. **S. A** me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik për periudhën korrik 2011 – nëntor 2013;

Meqënëse personat e mësipërm nuk janë në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

### **11. UJËSJELLËS KANALIZIME SHA POGRADEC (Auditimi tematik)**

Nga auditimi i ushtruar në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi shqyrtimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në procedurat e prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e Shoqërisë” dhe “Blerje automjeti për nevojat e punimeve të Shoqërisë, si dhe zbatimin e kontratave në lidhje me to”, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datë 01.03.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 57, datë 30.05.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 275/12, datë 30.05.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijëni, me shkresën nr. 278, datë 20.06.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuar.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec, me shkresën me nr. 501, datë 24.11.2016, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1 masë organizative**, e cila nuk është zbatuar.
- b. Për shpërblim dëmi është lënë **1 rekomandim**, i cila është në proces.
- c. Është rekomanduar **1 masë disiplinore**, për 7 persona gjendja e të cilave paraqitet;  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë **3 masa disiplinore e përkatësisht**; “**Vërejtje**” 3 masa nga të cilat 3 pranuar, nga të cilat janë zbatuar 3.  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë **2 masa disiplinore e përkatësisht**; “**Paralajmërim për largim nga puna**” 2 masa nga të cilat 2 pranuar, nga të cilat janë zbatuar 2.  
-Sipas **Kodit të Punës** janë lënë **2 masa disiplinore e përkatësisht**; “**Largim nga puna**” 2 masa nga të cilat 2 pranuar, nga të cilat janë zbatuar 2.
- d. Është rekomanduar **1 masë administrative**, e cila është në proces.

Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Pogradec i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 275/12, datë 30.05.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim A.1**

Nga ana e Auditit të Brendshëm të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime, Pogradec, të kryhet auditimi i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për të gjithë periudhën e drejtimit të saj nga ish-Drejtori i Përgjithshëm V. G, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë të gjitha procedurave

të prokurimit të zhvilluara përgjatë kësaj periudhe. (Një kopje e Raportit Përfundimtar të këtij auditimi ti dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit.)

*Menjëherë*

## **12. KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA**

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sha, Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2015 deri më datë 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 83 datë 30.06.2016, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1206/16 prot, datë 15.07.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 12/23 Prot., datë 04.08.2016 “Informacion për marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Për secilën masë organizative, shpërblim dëmi është nxjerr urdhrat respektiv nga Administratori, për zbatimin e detyrave të rekomanduara. Është hartuar plani i veprimit në zbatim të detyrave për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, plan i cili është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

-Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor. Në momentin e mbajtjes së këtij raporti, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. *Masa organizative: Janë rekomanduar 17 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 94 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 3, janë në proces zbatimi 11, zbatuar pjesërisht 1 dhe nuk është zbatuar 1.*

b. *Masa shpërblim dëmi Janë rekomanduar 14 për vlerën 391,808 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 12 masa ose 86 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 për vlerën 98,973 mijë lekë, janë zbatuar pjesërisht 5 për vlerën 25,924 mijë lekë, janë në proces zbatimi 4 për vlerën 192,756 mijë lekë.*

b2. *Të ardhura të munguara, si dhe realizim shpenzimesh jo në përputhje me parimin e efijencës monetare: Janë rekomanduar 3 për vlerën 2,400,035 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 3 masa ose 100 % e tyre . Janë në proces zbatimi 3 për vlerën 2,400,035 mijë lekë.*

c. *Masa me karakter disiplinor: Janë rekomanduar 16 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 16 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 3, është zbatuar pjesërisht 12, nuk janë zbatuar 1.*

Në përfundim rikërkojmë nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me nr. 1206/16 prot, datë 15.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim II.2**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri i vetëm, "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

*Në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim 1**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të rishqyrtojë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitin 2015 në vlerën 36,560,005 lekë (shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor), duke analizuar rezultatin financiar faktik vjetor në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Shoqërinë "Korporata elektroenergjetike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 6**

Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën 336,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit "Instalim i sistemit të ventilim-kondicionimit (HAVAC) në ndërtesën HEC Fierzë", viti 2015, pasi në strukturën e preventivit të këtij projekti, është vendosur zëri testim komisioni i pajisjeve dhe sistemit në vlerën 366,800 leke, ndërsa në ofertën fituese është paraqitur vlera 336,000 lekë, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e investimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Shoqërinë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 te Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 62, kontratave individuale të punës, pika 7, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi te kompetencave te tij ligjore, te fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

1. "**Zgjidhje të kontratës së punës**" për **Z. I. B**, me detyrë Drejtor i Divizionit të Gjenerimit.

2. "**Zgjidhje të kontratës së punës**" për **Z. B. S** me detyrë Drejtor i Departamentit të Shfrytëzimit në Divizionin e Gjenerimit.

3. "**Zgjidhje të kontratës së punës**" për **Z. E Gj**, me detyrë Inxhinier i kontrollit dhe monitorimit, reparti elektrik HEC Fierzë.

"**Vërejtje**" deri në "**Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate**", për:

1. **K. Gj**, me detyrë shef sektori, sektori i mirëmbajtjes HEC Vau Dejës.

2. **R. H**, me detyrë ekonomiste, sektori ekonomik HEC Vau Dejës.

3. **Rr. D**, me detyrë përgjegjës reparti, reparti hidroteknik HEC Vau i Dejës.

"**Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate**", për:

1. **B.H**, me detyrë inxhinier remonti, reparti mekanik HEC Fierzë.

2. **S. H**, me detyrë inxhinier mbrojtje rele dhe komandimi, reparti elektrik HEC Fierzë.

3. **G. Gj**, me detyrë teknik specialist ekspert i kualifikuar, Departamenti i Mirëmbajtjes, sektori elektrik.

**4.A. M**, me detyrë teknik specialist ekspert, Departamenti i Mirëmbajtjes, sektori elektrik.

**5.K. P**, me detyrë shef sektori, sektori teknik HEC Vau Dejes, në cilësinë e anetarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

**6.P. V**, me detyrë përgjegjës reparti, reparti elektrik HEC Fierz.

*Menjëherë*

### **13. AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Portual Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.11.2013 deri më datë 30.04.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 126, datë 30.09.2016, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 415/14 prot, datë 09.10.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Autoriteti Portual Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 2804/1 prot., datë 25.10.2016 “Plani i masave në lidhje me përfundimet e KLSH-së dhe rekomandimet e dërguara pranë APD-së me shkresë nr. 415/14 prot., datë 09.10.2016”, si dhe plan veprimi i këshillit drejtues të APD-së më nr. 2834/3 prot., datë 21.10.2016.

-Autoriteti Portual Durrës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor. Në momentin e mbajtjes së këtij raporti, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**a. Masa organizative:** Janë rekomanduar 34 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 34 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1, janë në proces zbatimi 30 dhe nuk janë zbatuar 3.

**b. Masa shpërblim dëmi** Janë rekomanduar 35 për vlerën 217,142 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 35 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 për vlerën 6,423 mijë lekë, janë zbatuar pjesërisht 8 për vlerën 6,101 mijë lekë, janë në proces zbatimi 19 për vlerën 88,546 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 4 për vlerën 116,072 mijë lekë.

**b2.Të ardhura të munguara**, si dhe realizim shpenzimesh jo në përputhje me parimin e efikasitetit monetar: Janë rekomanduar 4 për vlerën 170,825 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 4 masa ose 100 % e tyre. Janë në proces zbatimi 3 për vlerën 99,656 mijë lekë, është pa realizuar 1 në vlerën 71,169 mijë lekë.

**c. Masa disiplinore:** Janë rekomanduar 21 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 21 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 17, është zbatuar pjesërisht 1, nuk janë zbatuar 3.

Në masat disiplinore të rekomanduara theksojmë masën disiplinore “Largim nga detyra” të Drejtorit të Përgjithshëm të APD, masë që rezultoi e zbatuar nga Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës.

Në përfundim rikërkojmë nga Autoritetit Portual Durrës përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me nr. 415/14 prot, datë 09.10.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë

ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandimi V.3**

Nga APD dhe Këshilli Drejtues i saj, të mos kryhen propozime dhe vendimmarrje në lidhje me sponsorizimin e institucioneve të tjera shtetërore apo private, në kundërshtim me kompetencat e përcaktuara në ligjin për Autoritetin Portual, Statusin e APD dhe aktet e tjera në fuqi. Veprimtaritë e financuara jashtë funksioneve ligjore të APD i ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe të shpërblimit të efekteve financiare.

*Në vazhdimësi*

### **Rekomandimi V.4**

Nga APD të ndërpritet rimbursimi i shumave për telefoninë celulare për Këshillin Drejtues dhe sekretaren e Këshillit Drejtues, të cilat bien në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010.

-Në funksion të realizimit të detyrave funksionale, APD të pajisë ambientet e punës së sekretares së Këshillit Drejtues me telefoni fikse dhe me shërbimin përkatës të telefonisë.

*Në vazhdimësi*

## **B. 1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandimi 1**

Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **47,994,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos vënien në punë të peshores elektronike me vlerë investimi **47,994,000 lekë**, pasi ky investim, nuk ka justifikuar kryerjen e këtij shpenzimi, që ka të bëjë me instalimin e sistemit të integruar të peshimit elektronik, i cili duhet të përshpejtojë procedurat e brendshme të operimit, rritjen e sigurisë së veprimeve të brendshme, mirë administrimin e të ardhurave të Autoritetit Portual, si dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit përkundrejt operatorëve. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, Vlera **47,994,000 lekë** për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**. Në rast mos-zbatimi të këtij rekomandimi, KLSH do të denoncojnë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë prekjën e interesave ligjshme të APD dhe të Shtetit.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 14**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **921,360 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor: Hyrja nr. 2 - Terminali i trageteve”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese OE [REDACTED] me vlerë 11,010,800 lekë, me ofertën e OE [REDACTED] me vlerë 10,243,000 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 15**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **867,353 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemimi i pjesës pranë rrethimit TIR në krah të rrugës- Hyrja 4- Terminali i trageteve”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese OE [REDACTED] me vlerë 11,099,640 lekë, me ofertën e

bashkimit të ■■■ me vlerë 10,376,846 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 18**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **120,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Zëvendësimi i kangjellave në Terminalin Perëndimor”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese OE ■■■ me vlerë 3,700,000 lekë, me ofertën e OE ■■■ me vlerë 3,600,000 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

#### **Rekomandimi 17**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **615,360 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Shtesë kontrate blerje uniforma dhe veshje pune për APD”, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e mallrave, pasi për 10 artikuj çmimi i kontraktuar është më i lartë se çmimi i kontratës fillestare nr. 290, datë 29.01.2015 “Blerje uniforma dhe veshje pune për APD”. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 19**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **648,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e shërbimeve, pasi në preventivin e këtij shërbimi është vendosur zëri “Trajnim për përdorimin e pajisjeve të laboratorit”, zë i cili është prokuruar njëherë me kontratën nr. 1748, datë 12.07.2011, me objekt “Sistemi elektronik dhe pajisje për monitorimin ambiental”, me vlerë 8,218,380 lekë pa tvsh. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

**Rekomandimi 20.** Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **1,704,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 514, datë 18.02.2015, me objekt “Konsulencë për laboratorin mjedisor”, për arsye se nga verifikimi fizik i datës 22.07.2015, u konstatua se dokumentacioni i hartuar nga kontraktori ■■■, nuk përdoret nga laboratori i APD. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

**Rekomandimi 21.** Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **59,222 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Zbatim-ndërtim i bazamentit të sillosave të drithit dhe spostimin e tyre në sheshin pas kalatës 2”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese ■■■ me vlerë 14,594,000 lekë, me ofertën e bashkimit të OE ■■■ me vlerë 14,544,648 lekë, e cila është skualifikuar pa të drejtë. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit përbën **dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 25.**

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të **prezantohet** në organet drejtuese vlera **1,165,868 lekë**, që ka të bëjë me llogaritjen e tarifës për kontratat e lidhura për shesh përdorimi nga

koncensionari ■■■ (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncensionari ■■■ në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr 581/1, datë 06.02.2013 ”Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”. Vlera **1,165,868 lekë** përbën **dëm ekonomik** për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 27**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **198,500 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin Personit Fizik ■■■ për riparimin e makinave me targë DR6432E dhe me targë DR6625E, pa procedurë prokurimi. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 29**

Këshilli Drejtues të shqyrtojë vlerën **486,377 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në likuidimin nga APD të shoqërisë ■■■ shpk për llogari Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi 34**

Këshilli Drejtues të rishqyrtojë vlerën **3,048,293 lekë ose 22,410 EUR**. Kjo vlerë ka të bëjë me shtesën e pa argumentuar të organikës të personelit të Njesisë së zbatimit të Projektit BEI-BERZH për kalatën 7 dhe 8, në 5 punonjës për periudhën Qershor 2015 deri në mars 2016, pasi kjo shtesë ka ardhur kur nga ky projekt ka ngelur vetëm faza e dytë, për të cilën është kryer tenderimi në vlerën 2,200,000 EUR. Në fazën e parë janë shpenzuar 25.83 milion euro, me personel prej 3 punonjës të PIU, ndërsa për periudhën Qershor 2015 deri në mars 2016 është bërë 8 punonjës. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

### **B.3. TË ARDHURA TË MUNGUARA NGA PROCESI I SHKARKIMIT, DEPOZITIMIT DHE EVADIMIT I TUBACIONEVE, MATERIALEVE TË NEVOJSHME, SI DHE MAKINERIVE TË PROJEKTIT TAP.**

#### **Rekomandimi 1**

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv **të prezantohet** në organet drejtuese vlera **71,168,800 lekë**, që ka të bëjë me procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme si dhe makinerive të Projektit ■■■ të realizuar nga kompania ■■■ dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit ■■■ duke krijuar të **ardhura të munguara** për APD dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën **71,168,800 lekë**, vetëm për linjën tokësore, pa përfshirë atë detare që është dhe pjesa më e rëndësishme e projektit. Konkretisht: Shkarkimi nga kompania ■■■ i tubacioneve të ■■■ dhe të materialeve të tjera në funksion të tyre, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.2. 1 të kontratës koncensionare, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Do t’i sigurojë



*Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD, me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për lëshimin e tyre”.*

Organet drejtuese të APD të analizojnë dhe të denoncojnë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen ose jo të rregullt të detyrës, me pasojë preken e interesave ligjshme të APD dhe të Shtetit.

*Menjëherë*

### **C. MASA DISIPLINORE**

**“Largim nga puna”, për:**

**1. Xh. T,** në cilësinë e drejtorit i PIU BEI BERZH

**2. A. Gj,** me detyrë menaxher i Terminalit Perëndimor.

**“Zbritje në detyrë” për:**

**1. B. Dh,** me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm ekzekutiv.

**2. A. N** me detyrë drejtor i drejtorisë së kontratave çështjeve ligjore dhe koncesioneve për periudhën 10.04.2009 dhe në vazhdim.

*Menjëherë*

### **14. SHOQËRIA “UJËSJELLËS KANALIZIME” SHA LUSHNJË**

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Lushnjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.05.2013 deri më datë 31.08.2015 dhe finalizuar me Vendimin nr. 172 datë 28.12.2015, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2015 konstatohet se:

- Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA Lushnjë në kundërshtim me neni 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, *nuk ka kthyer përgjigje në KLSH në lidhje me marrjen e masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.* Pavarësisht këtij fakti me vendim nr. 5, datë 05.02.2016 këshilli mbikëqyrës, ka vendosur zbatimin e të gjitha detyrave të lëna nga KLSH dhe dhënien e masave disiplinore, për zbatimin e këtij vendimi është ngarkuar drejtorja e sh.a. Për secilën masë organizative, të masave të shpërblim dëmi dhe disiplinore është nxjerr nga Administratori i Shoqërisë urdhri nr. 5/1 datë 08.02.2016, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.

-Në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA Lushnjë, *nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.*

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**A. Masa organizative:** Janë rekomanduar 36 masa nga të cilat janë pranuar 36 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2, janë në proces zbatimi 20, zbatuar pjesërisht 2 dhe nuk janë zbatuar 12 masa.

**B Masa shpërblim dëmi:** Janë rekomanduar 12 për vlerën 135,091 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 12 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 për vlerën 1,020 mijë lekë, është zbatuar pjesërisht 1 për vlerën 326 mijë lekë, është në proces zbatimi 1 për vlerën 89,957 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 9 masa për vlerën 44,788 mijë lekë.

**C. Masa disiplinore:** Janë rekomanduar 14 nga të cilat janë pranuar 14 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 14 masa.

Në përfundim rikërkojmë nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me nr. 801/6 prot, datë 28.12.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, edhe pse ka kaluar afati 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

## **MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandimi I.2**

Nga Këshilli Mbikëqyrës, të rishqyrtohen vendimet nr. 7, 8, 9, 10 dhe 11 të datës 27.12.2013, si dhe vendimi nr. 13, i datës 22.08.2014, të cilat janë marrë pa pasur kuorumin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të vlefshme në përputhje me rendin e ditës, fakt i provuar (vërtetuar) nga libri i protokollit, të merret vendimi përkatës dhe të miratohet në asamblenë e aksionarit (këshillin bashkiak).

*Në vazhdimësi*

### **Rekomandimi I.3**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet vlera **22,763,728 lekë**, që përfaqëson kamatëvonesa për mos likuidimin në kohë ose jo të faturave të ujit të pijshëm, si dhe të merret vendimi përkatës për arkëtimin e kësaj vlere, pasi kjo përbën një të ardhur të munguar për Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lushnjë.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi I.5**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për të përcaktuar tarifën e prerjes, tarifën e rilidhjes, tarifën e vulosjes së matësit dhe të penaliteteve të tjera, tarifa të cilat duhet të përmirësojnë faturën e ujit.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi I.6**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e një rregullore të veçantë për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundravajtjes administrative si: Akt konstatimi, hartimi i procesverbaleve, vendosjen e gjobave, regjistrimi i gjobave, zyrat ku depozitohet akt konstatimi, gjoba, si dhe procedurat për arkëtimin e gjobave etj.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi I.7**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi I.10**

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në Ministrinë e Financave marrëveshja e lidhur datë 14.10.2013 ndërmjet Shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime Lushnjë” sh.a Lushnjë dhe bashkimit të [REDACTED] “Për Financimin dhe Instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EËMS) në Qytetin e Lushnjës dhe zonat përreth”, me vlerë 1,700,000 EURO, pa TVSH, dhe të informohen organet drejtuese për gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë (me humbje për vitet 2012, 2013, 2014 dhe e parashikuar me humbje për vitin 2015), si dhe me barrën e shlyerjes së kredive (dy kredi të tjera vetëm me pricipial 6,401,626 euro, pa përfshirë

interesat), si pasojë e së cilës kjo shoqëri jo vetëm është në gjendjen e paaftësisë paguese, por është plotësisht e falimentuar bile në rastin më të keq, të një falimenti të provokuar nga organet drejtuese të sajë (këshilli mbikëqyrës, këshilli bashkiak dhe administratori i shoqërisë).

Organet drejtuese të shoqërisë të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi I.11**

Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet kontrata e kredisë e lidhur datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sha, Lushnjë përfaqësuar nga A .D dhe ■■■, si dhe të merret vendimi përkatës për zbatimin e saj konform legjislacionit përkatës.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi I.12**

Nga Administratori i Shoqërisë të negociohet me ■■■ për të saktësuar pikën 14 “Tarifat dhe Komisionet Bankare” të kontratës së kredisë të lidhur datë 03.12.2013 ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sha, Lushnjë përfaqësuar nga A. D dhe ■■■ për sa i përket komisionit (çelje kredie+komision lëshim garancie+transferta sëift) prej 2.4%, komisioni i cili duhet të likuidohet në favor të ■■■ sipas një plan amortizimi (2.4% të vlerës së mbetur të shlyerjes së principialit të kredisë dhe jo 2.4 % të shumës totale prej 1,070,00 euro).

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi I.14**

Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa që në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë, të jetë organizuar dhe të funksionojë Njësia Auditit të Brendshëm, në zbatim të VKM nr. 345, datë 1.6.2004 “Për aprovimin e manualit të procedurave të Auditit të Brendshëm, mbi Kodin e Auditit të Brendshëm dhe mbi Auditimin e Brendshëm Publik”, seksioni II, pika 8.

*Në vazhdimësi*

#### **Rekomandim I.15**

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura komerciale dhe industriale, që vijnë nga subjektet shkarkuese komerciale dhe industriale, si dhe të kryhen analizat e ujërave të ndotura, në zbatim të standarteve shtetërore të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve sh.a”, Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse” dhe Ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.

-Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Lushnjë, për të mbajtur regjistrin shkrimor dhe elektronik të ujërat të ndotura, që nuk mund të shkarkohen në sistemin publik të kanalizimeve (komerciale dhe industriale), vend mbajtjen e tyre dhe largimin në mënyre legale dhe të autorizuar, si dhe regjistrin e heqjes së llumit nga gropat septike, gropat e banjave, duke zbatuar procedurat e përcaktuara sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU-ja.

*Menjëherë*

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

#### **Rekomandim 2**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës, i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve, dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të përcaktuara



### **Rekomandim 7**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 9,656,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me 1207 apartamente në pallatet e reja shumëkatëshe për të cilat nuk janë lidhur kontratat e ujit të pijshëm, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 8**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 118,800 lekë** nga ekspertët **E. Dh dhe B. B.** Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht, për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë për vitin 2013, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 9**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet **vlera 30,000 lekë**, që përfaqëson gjoba të paguara nëpërmjet [REDACTED], me transaksionin nr. 9, datë 06.02.2013 dhe nr. 22, datë 26.03.2013, për arsye të mos regjistrimit brenda afatit të shoqërisë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë pranë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe mos dërgim në kohë të Pasqyrave Financiare, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtim, vlerë e cila për shoqërinë “Ujësjetllës kanalizime” sh.a Lushnjë dhe buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

*Menjëherë*

### **Rekomandim10**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë të analizohet **vlera 113,400 lekë**, që përfaqëson shpenzim për drekë festive të Vitit të Ri, 2012 në vlerën 113,400. Ky shpenzim është kryer në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 849, datë 06.12.2012, për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, si dhe të merret vendimi përkatës për zhdëmtim.

*Menjëherë*

### **15. SPITALI UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI” TIRANË**

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Zbatimin e ligjshmërisë, dhe rregullshmërisë ekonomiko financiare”, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015” dhe trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 53, datë 14.05.2016, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1211/7, datë 16.05.2016, konstatohet se:

-Spitali Universitar Shefqet Ndroqi” Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor. Në momentin e mbajtjes së këtij raporti, subjekti është brenda këtij afati të raportimit të ecurisë së rekomandimeve sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**a. Masa organizative:** Janë rekomanduar 24 masa nga të cilat janë pranuar 24 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 2, janë në proces zbatimi 18, zbatuar pjesërisht 1 dhe nuk janë zbatuar 3.

**b. Masa shpërblim dëmi:** Janë rekomanduar 2 për vlerën 35,268 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 2 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë në proces zbatimi 2 për vlerën 35,268 mijë lekë.

**b.1.Të ardhura të munguara,** si dhe realizim shpenzimesh jo në përputhje me parimin e efikasitetit monetar: Janë rekomanduar 4 për vlerën 9,972 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 4 masa ose 100 % e tyre . Janë në proces zbatimi 4 për vlerën 9,972 mijë lekë.

Në përfundim rikërkojmë nga Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën 1211/7 prot., datë 16.05.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, përse kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna.

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

##### **Rekomandim 4**

Dosjet e personelit të 11 shefave të shërbimeve dhe e Drejtorit të Spitalit, të plotësohen me deklaratat e konflikti të interesit të konfirmuara nga Ministria e Shëndetësisë.

*Menjëherë*

##### **Rekomandim 6**

Të merren masa për miratimin e pasqyrave financiare nga Këshillin Administrativ.

*Menjëherë*

#### **16.SHOQËRIA “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT” SH.A TIRANË**

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” Sh.a Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2014 deri më datë 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 41, datë 28.04.2016 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1207/7, datë 29.04.2016, konstatohet se:

-Me shkresën protokolluar në KLSH me nr. 1207/8 datë 13.06.2016 të Administratorit të OST Sh.a është dërguar në KLSH programi i punës për zbatimin e rekomandimeve.

OST Sh.a për zbatimin e rekomandimeve ka përgatitur një program pune dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të shoqërisë.

-Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se *ky afat nuk është zbatuar dhe se është dërguar ky plan veprimi jashtë afatit*, në kundërshtim me neni 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Ndërsa përse i përket zbatimit të afatit 6-mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, u konstatua *se nuk është raportuar sipas pikës 2, të nenit 30 ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**a. Masa organizative:** Janë rekomanduar 29 nga të cilat janë pranuar 29 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 16, janë në proces zbatimi 13.

**b. Masa shpërblim dëmi** Janë rekomanduar 6 për vlerën 15,000 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 6 për vlerën 15,000 mijë ose 100 % e tyre.

Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 për vlerën 820 mijë lekë, janë në proces zbatimi 4 për vlerën 14,180 mijë lekë.

**b2. Të ardhura të munguara**, si dhe realizim shpenzimesh jo në përputhje me parimin e efikasitetit monetar: Janë rekomanduar 2 për vlerën 976,340 mijë lekë nga të cilat nga të cilat janë pranuar 2 për vlerën 976,340 mijë lekë ose 100 % e tyre . Janë në proces zbatimi 2 për vlerën 976,340 mijë lekë.

**c. Masa me karakter disiplinor:** Janë rekomanduar 34 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 34 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 34.

Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” Sh.a Tiranë nuk do ti drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

### **17. SHOQËRIA “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A MIRDITË**

Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Mirditë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “për zbatimin praktikës së mbylljes së kontratës me objekt “Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, Faza e II, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 159, datë 14.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 728/6 prot, datë 14.12.2015, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Mirditë, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 201/1 prot, datë 30.12.2015 “Kthim përgjigje shkresës nr. 728/6 prot. datë 14.12.2015”.

Për sa më sipër është hartuar plani i masave (ose plan veprimi) me nr. 201/5 prot. datë 30.12.2015 nga Administratori i UK Sh.a Mirditë.

- Ujësjellës Kanalizime Sh.a Mirditë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**a. Masa për propozime për përmirësime në legjislacionin në fuqi:** Është rekomanduar një, masë e cila është pranuar. Ky rekomandim është në proces.

**b. Masa organizative:** Janë rekomanduar 5 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 5 masa. Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1, ndërsa janë në proces zbatimi 4.

Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Mirditë do ti drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

### **18. ALBCONTROL SHA**

Nga auditimi i ushtruar në Albcontrol SHA, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes të cilat janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 21, datë 17.03.2016, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1212/6 prot, datë 17.03.2016, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Albcontrol SHA, ka kthyer përgjigje në

KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 8/5, dt. 08.04.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Titullarit nr. 575, dt. 01.04.2016 dhe urdhrin nr. 575/1, datë 01.04.2016, është ngritur grupi i punës për analizimin e gjetjeve dhe rekomandimet e KLSH-së, i cili ka pasur për detyrë të raportonte për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, në zbatim të programit të miratuar nga titullari i subjektit.

-Albcontrol SHA, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me piken 2, neni 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 15 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 15 masa. Nga rekomandimet janë zbatuar plotësisht 6, janë në proces 5 dhe janë të pa zbatuara 4 rekomandime.*
- b. *Për shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe është zbatuar plotësisht.*

Sa më sipër, rikërkojmë që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Albcontrol SHA i rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1212/6, datë 17.03.2016, mbi auditimin me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, si më poshtë:

## **A.MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim 2**

Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të marrë masa për të kontrolluar zbatimin e programit të Auditit të Brendshëm në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, i ndryshuar, pjesa IV “Kompetencat e këshillit mbikëqyrës”, pika 6, duke trajtuar auditime të veçanta që kanë të bëjnë me miradministrimin e fondeve të shoqërisë.

*Vazhdimisht*

### **Rekomandimi 7**

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar koston e mallrave që do të prokurohen, për të njohur nivelin aktual të tregut dhe për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin e fondeve publike për zbatimin dhe përmbushjen me përpikmëri të planit të prokurimit të miratuar, me qëllim përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efijencë të burimeve financiare të shoqërisë.

*Vazhdimisht*

### **Rekomandimi 9**

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në të ardhmen gjatë programimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe punime:

- të hartojë kërkesa për kualifikim, që sigurojnë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit, për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin me efijencë të përdorimit të fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale;



- nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit;
- sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

*Vazhdimisht*

### **Rekomandimi 11**

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në të ardhmen të analizojë dhe të përcaktojë në kushtet e kontratës / dokumentet standarde të tenderit, termat e referencës dhe të mos i ndryshojë ato gjatë lidhjes së kontratave me operatorët ekonomikë, për të siguruar transparencë dhe barazi midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

*Vazhdimisht*

### **19. BASHKIA TIRANË PËR PROJEKTIN “RIKONSTRUKSIONI DHE ZHVILLIMI I RRUGËVE LOKALE DHE SEKONDARE NË BASHKINË TIRANË”**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për Projektin “Rikonstruksioni dhe Zhvillimi i Rrugëve lokale dhe sekondare në Bashkinë Tiranë”, për periudhën e veprimtarisë nga viti 2013 deri më datë 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes të cilat janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH 176, datë 29.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 802/6 prot , datë 29.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashki Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijeni, me shkresën nr. 2018 ,dt. 22.01.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara. Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 19058, dt.24.11.2015 dhe urdhrin nr. 10013, datë 01.04.2016, është ngritur grupi i punës për transferimin e të gjitha asetëve dhe detyrimeve financiare (kostos lokale) të NJZP, i cili ka pasur për detyrë të raportonte për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, në zbatim të programit të miratuar nga titullari i subjektit.

-Bashkia Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me piken 2, neni 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **19 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 15 , 4 nuk janë pranuar , nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 7, 8 janë në proces dhe janë të pa zbatuara 5 rekomandime.

**b.** Për **shpërblim dëmi** janë lënë **2 rekomandime**, nga të cilat 1 është pranuar plotësisht dhe 1 nuk është pranuar. Nga të pranuarat, është në proces 1 rekomandim.

Sa më sipër, rikërkojmë që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Bashkisë Tiranë i rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 802/6, datë 29.12.2015, mbi auditimin me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandimi 3**

Bashkia Tiranë dhe NJZP, të marrë masat e nevojshme për plotësimin strukturës organizative të projektit me punonjës të kualifikuar dhe të eliminohen lëvizjet e shpeshta të personelit.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 5**

Njësia e Zbatimit të Projekteve të përcaktojë rregulla dhe procedura të qarta për menaxhimin e aktiveve, si dhe ndarje të funksioneve për stafin në përputhje me ligjin nr 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 6**

Bashkia Tiranë dhe NJZP të marrë masat e nevojshme për përfundimin në afatet e parashikuara në marrëveshje të projekteve me financime të huaja, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm nga Njësia e Zbatimit të Projektit, me qëllim për të shmangur rritjen e kostove financiare, si dhe sigurimin e maksimumit të përfitimeve.

*Në vazhdimësi*

### **Rekomandimi 7**

Njësia e Zbatimit të Projekteve, t’i përmbahet me rigorozitet raportimeve, hapjes së llogarive krahas asaj kryesore, si dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, për të pasur ecuri normale të zbatimit të tyre.

*Në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandimi 1**

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të marrin masa për arkëtimin e vlerës së penalteteve, për mospagesën në afat të faturave të shërbimit të internetit **në vlerën 96, 348 lekë**, nga ish drejtorja J. L dhe ish specialistja e financës S. M.

*Menjëherë*

## **20. URDHRI I STOMATOLOGUT**

Nga auditimi i ushtruar në Urdhrin e Stomatologut, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për financimin fillestar nga Buxheti i Shtetit, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.62, datë 16.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 191/7, datë 17.06.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Urdhri i Stomatologut, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. nr. 191/7, datë 17.06.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

- Urdhri i Stomatologut, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, për arsye se nuk është plotësuar ky afat në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

*Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa organizative, nga të cilat janë realizuar plotësisht 5 rekomandime.*

*Në përfundim, Urdhrit të Stomatologut, nuk do ti dërgohet shkresë për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 191/7, datë 17.06.2016, mbi auditimin me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” sepse rekomandimet rezultojnë të zbatuara.*

## **21.DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorin e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Për auditimin e zbatimit të përputhshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare” përperiudhën 01.06.2013-31.05.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.106, datë 19.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 507/21, datë 19.09.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorja e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 2155/1, datë 12.10.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afatit të përcaktuar.

-Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorja e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, për arsye se nuk është plotësuar ky afat.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat janë realizuar plotësisht 9 rekomandime dhe 8 rekomandime janë në proces zbatimi.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 7 rekomandime nga të cilat 2 është zbatuar dhe 5 janë në proces zbatimi.
- c. Janë rekomanduar 2 masa disiplinore dhe janë zbatuar 2 masa disiplinore (me kod pune).

*Drejtoria e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave i rikërkojmë përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 507/21, datë 19.09.2016, mbi auditimin me objekt “Për auditimin e zbatimit të përputhshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar në proces zbatimi, si më poshtë:*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandimi nr. 1**

Enti Kombëtar i Banesave t'i kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, zbritjen e vlerës 23,341,222 lekë nga subvencionin që merr [REDAKTUAR] nga Buxheti i Shtetit për familjet që përfitojnë kredi të

lehtësuara, për moszbatim të transparencës dhe dhënies së informacionit për mënyrën e llogaritjes së interesit në kontratën me konsumatorët.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi nr. 2**

Të merren masa nga Enti Kombëtar i Banesave, që ti kërkojë operatorit ekonomik [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 1,325,232 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në objekt.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi nr. 4**

Të merren masa nga Enti Kombëtar i Banesave, që ti kërkojë shoqërisë [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 377,366 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në objekt.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi nr. 6**

Të merren masa nga Enti Kombëtar i Banesave, që ti kërkojë shoqërisë [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 319,200 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në objekt.

*Menjëherë*

#### **Rekomandimi nr. 7**

Të merren masa nga Enti Kombëtar i Banesave, që ti kërkojë operatorit ekonomik [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 247,800 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në objekt.

## **22. AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE (ISH DPUK)**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 30.04.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 104, datë 19.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 506/10, datë 19.09.2016, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AKUK nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani.

- AKUK nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, për arsye se nuk është plotësuar ky afat në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 34 masa organizative, të cilat janë në proces zbatimi.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 5 rekomandime nga të cilat 4 janë në proces zbatimi dhe 1 nuk është zbatuar.
- c. Janë rekomanduar 4 masa për shpenzime jo në përputhje me 3-E të cilat janë në proces zbatimi;
- d. Janë rekomanduar 3 masa administrative nga të cilat 2 janë në proces dhe 1 nuk është zbatuar.

- e. Janë rekomanduar 14 **masa disiplinore** nga të cilat janë zbatuar 9 masa disiplinore (1 kod pune) dhe nuk janë zbatuar 5 masa.

Në përfundim rikërkojmë nga Agjencia Kombëtar e Ujësjetës Kanalizimeve përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 506/10, datë 19.09.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara ose në process realizimi, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna si më poshtë:

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandimi 1**

DPUK të marrin masa për arkëtimin e vlerës **4,335,948 lekë**, nga OE [REDAKTUAR], si dëm ekonomik i ardhur nga likuidimi i punimeve të pakryera për kontratën me objekt “Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm”, por të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 2**

DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **37,443 lekë**, vlerë e sigurimit të ofertës, ndaj OE [REDAKTUAR] i cili është tërhequr nga procedura “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave.

-DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,010,000 lekë**, ndaj anëtarëve të KVO, F. M, L. T dhe S. Z, për skualifikimin e padrejtë të OE [REDAKTUAR] nga procedura “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II” për mungesën e certifikatave ISO për punime në ujësjetësia.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 3**

DPUK të marrin masa për arkëtimin e vlerës **53,929 lekë**, nga BOE [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], si dëm ekonomik i ardhur nga likuidimi i punimeve të pakryera për shtesën e kontratës me objekt “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (shtesë kontrate)”, por të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi.

*Menjëherë*

### **Rekomandimi 4**

DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **13,900 lekë** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, i përbërë nga z. D. Z, znj. V. Th dhe znj. A. M, për skualifikimin e OE me pa të drejtë nga procedura e prokurimit “Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik”.

*Menjëherë*

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

IKMT pas shqyrtimit të rekomandimeve të KLSH ka përcjell në AKUK (ish DPUK) gjobat për 3 mbikëqyrës të punimeve. DPUK ka nxjerr aktet administrative përkatëse vetëm për dy prej tyre.

### **Rekomandimi 3**

- Gjobë për z.B.D në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në shumën 50 mijë lekë.

*Menjëherë*

## **E. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr.

152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115 date 5.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen ne komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUK (ish DPUK), që të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

a) “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, neni 58 pika b, për:

1. **Z. G. A** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe ne cilësinë e kryetarit te KVO

2. **Z. L. T** në cilësinë e anëtarit të KVO

3. **Z. A. M** në cilësinë e anëtarit të KVO

4. **Z.Z. I** me detyrë specialit ne Drejtorinë Teknike dhe ne cilësinë e kolaudatorit te punimeve  
*Menjëherë*

### **23. PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE” ( Auditim i kryer në subjektin AKUK)**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” nga fillimi i projektit deri në 30.08.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 167, datë 28.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 803/8, datë 28.12.2015, konstatohet se:

- AKUK nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijeni në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

- AKUK nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, por është brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

***Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat janë realizuar plotësisht 9 rekomandime dhe 8 rekomandime janë në proces zbatimi.***

*Në përfundim, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, nuk do ti dërgohet shkresë për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 803/8, datë 28.12.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe” sepse rekomandimet rezultojnë në proces zbatimi, por do t’i tërhiqet vëmendja, për mungesën e raportimit nga ana e saj, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

### **24. MINISTRIA E SHËNDETËSISË PËR PROJEKTIN “SHËNDETËSIA ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI, REGJISTRI MBARË KOMBËTAR I SHËNDETËSISË ELEKTRONIKE”**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë për projektin “Shëndetësia Elektronike në Shqipëri, regjistri mbarë kombëtar i shëndetësisë elektronike” për zbatimin e

rekomandimeve të KLSH, “Mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare” nga fillimi i projektit deri në 28.02.2016 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 77, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 251/6, datë 30.06.2016, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Shëndetësisë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijoni, me shkresën nr. 1220/30, datë 21.07.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

- Ministria e Shëndetësisë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, për arsye se nuk është plotësuar ky afat në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 12 masa organizative, nga të cilat janë realizuar plotësisht 9 rekomandime dhe janë në proces realizimi 3 rekomandime.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat janë realizuar plotësisht 2. Shuma e arkëtuar 135,840 Euro.
- c. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore, bazuar në statusin e nëpunësit civil, të cilat janë realizuar plotësisht.

Në përfundim, Ministrisë së Shëndetësisë, nuk do ti dërgohet shkresë për rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 803/8, datë 28.12.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” sepse rekomandimet rezultojnë në proces zbatimi.

## **25. NDËRMARRJA “TRAJTIMIT TË STUDENTIT NR. 3” SHA, TIRANË**

Nga auditimi i ushtruar në Ndërmarrjen “Trajtimi i Studentit nr.3” ShA Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.43, datë 30.04.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 41/8, datë 03.05.2016, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ndërmarrja “Trajtimi i Studentit nr. 3” ShA, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën 41/9, datë 26.05.2016 dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

-Ndërmarrja “Trajtimi i Studentit nr. 3” ShA, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 476, datë 22.09.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 24 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 23 dhe nuk është pranuar 1. Nga rekomandimet e pranuar janë zbatuar plotësisht 10 prej tyre, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim dhe janë në proces zbatimi 12 të tjera.

*b. Për masën shpërblim bëmi janë lënë 7 rekomandime në vlerën 6,693 mijë lekë , nga të cilat janë pranuar plotësisht 5 prej tyre dhe nuk është pranuar 1 rekomandim. Nga rekomandimet e pranuar, është zbatuar një rekomandim në vlerën 40 mijë lekë, është zbatuar pjesërisht 1 tjetër në vlerën 54 mijë lekë dhe janë në proces 4 rekomandime në vlerën 5,684 mijë lekë.*

*c. Janë rekomanduar 5 masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, të cilat sipas Kodit të Punës janë lënë “Në kompetencë të Titullarit dhe Këshillit Mbikqyrës”. Nga këto masa, janë zbatuar 4 prej tyre dhe nuk është zbatuar një masë.*

Ndërmarrjes “Trajtimi i Studentit nr. 3” ShA, Tiranë i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 41/8, datë 03.05.2016, mbi auditimin me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, për vitin 2013-2015”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim 6**

Këshilli Mbikqyrës të marrë masa dhe të analizojë, evidentojë përgjegjësitë konkrete, për tejkalimin e numrit mesatar të punonjësve krahasuar me strukturën e miratuar, dhe tejkalimin e fondit të pagave dhe shpërblimeve në vlerën 7,250,000 lekë, për vitin 2013, në vlerën 68,500 lekë për vitin 2014 dhe në vlerën 3,032,700 lekë për vitin 2015.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 7**

Këshilli Mbikqyrës, të marrë në analizë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete për efektin financiar negativ në vlerën 12,764,097 lekë, të shkaktuar nga ndërprerja e marrëdhënieve administrative të punës për 19 punonjës të shoqërisë, si dhe të marrë masa për mos përsëritje në të ardhmen. Juristi i shoqërisë të marrë masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

### **Rekomandim 3**

Këshilli Mbikqyrës, në kushtet e nxjerrjes së një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, të iniciojë procedurat e rikuperimit të pasojave ekonomike të këtij akti, duke i kërkuar **z. E. M** (Administrator i shoqërisë) kthimin e shumës prej 915,067 lekë si shumë e përfituar në mënyrë të padrejtë nga ana e tij dhe të pabazuar në asnjë dispozitë ligjore.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 5**

Të merren masa nga Këshilli Mbikqyrës, që t’i kërkojë personave përgjegjës shpërblimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës për:

1. Vlera 34,000 lekë, nga ish-titullari **z. S. D**
2. Vlera 20,000 lekë, nga ish-zëvendës titullari **z. H. M**

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Në kompetencë të Këshillit Mbikqyrës të marrë masat disiplinore “Vërejtje me shkrim”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për:

1. **Z. E. M**, me detyrë Administrator i shoqërisë “Trajtimi i Studentit Nr. 3”

*Menjëherë*

## **26. FONDI SHQIPËTAR I ZHVILLIMIT**



Nga auditimi i ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e Projektit Rehabilitimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” për periudhën 01.01.2016 deri më 31.03.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.68, datë 29.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 252/8, datë 30.06.2016, konstatohet se:

-FSHZH nuk ka zbatuar detyrimin ligjor prej 20 ditë mbi hartimin e plan-veprimit dhe kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga FSHZH, nuk është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. **13 masa organizative** për përmirësimin e gjendjes, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4 prej tyre, janë në proces zbatimi 7 të tjera dhe nuk janë zbatuar 2 rekomandime.
- b. Nga 8 masa “Shpërblim dëmi” në vlerën 10,461,560 lekë, të rekomanduara nga KLSH, janë zbatuar 3 masa në vlerën 777,956 lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 2,671,892 lekë dhe 4 masa në vlerën 3,762,142 lekë janë në proces zbatimi.
- c. Është propozuar 1 masë për përdorimin me efektivitet të fondeve, e cila është në proces zbatimi.
- d. Janë rekomanduar 7 masa disiplinore “Vërejtje” deri në “Largim nga Puna”, të cilat sipas Kodit të Punës janë lënë në kompetencë të titullarit. Nga masat e lëna, janë zbatuar plotësisht të gjitha.

Sa më sipër, i rikërkojmë FSHZH që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe përsheptimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 252/8, datë 30.06.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e Projektit Rehabilitimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht ose të papranuara, si më poshtë, si dhe do t'i tërhiqet vëmendja për mosrespektim të kërkesave të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në drejtim të raportimit në KLSH:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **Rekomandim 1**

FSHZH, të marrë masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve të përealizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, me qëllim realizimin e dy propozimeve organizative dhe të një mase administrative.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 6**

- FSHZH, për projekte në proces dhe që do financohen në të ardhmen, në bashkëpunim me

donatorët, të marrë masa për vendosjen e kriterit për mos nënshkrimin e kontratës me operatorin e dytë të renditur (apo operatorë të tjerë), nëse diferenca e ofertave është më e madhe se vlera e garancisë së ofertës, në mënyrë që të minimizohen mundësitë për abuzime nga ana e operatorëve ekonomikë dhe të rriten përfitimet nga proceset e prokurimit.

- Në prokurimet që do realizohen nga FSHZH në të ardhmen, të merren masa për vendosjen e vlerës së garancisë në masën 2 %, në mënyrë që të ketë mbrojtje nga tërheqjet e mundshme të operatorëve ekonomikë nga gara.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **Rekomandim 2**

FSHZH të marrin masa për arkëtimin e vlerës 3,249,570 lekë, nga operatori [REDAKTUAR], si dëm ekonomik i ardhur nga mosmbajtja e sigurimit të ofertës në tenderin me objekt Rikonstruksioni i segmentit 1 Maj-Unaza, Himare.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 7 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se janë zbatuar të gjitha masat.

### **27. MINISTRIA ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRIA E FINANCAVE ( Auditim tematik për Këshillat Mbikqyrës)**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe në Ministrinë e Financave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Për auditimin e ushtruar mbi zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor në drejtim të krijimit, përbërjes dhe shpërblimit të bordeve, këshillave, komisioneve apo organeve të tjera kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*” për periudhën 01.10.2011 deri 30.06.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.137, datë 30.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresat nga nr. 527/197 deri në nr. 527/215 datë 10.10.2015, dërguar kryetareve të Bordeve, Këshillave, Komisioneve dhe Organeve të tjera Kolegjiale, Kontrolli i Lartë i Shtetit u ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të rekomanduara.

Në mbështetje të nenit 15, germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, me shkresën nr. 7766/1 , datë 29.10.2015 “Lidhur me raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet”, dhe “Ministria e Financave” me shkresën dërguar me nr.7100/37, datë 27.10.2015,”Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH”, kanë dërguar programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Ujështetës Sh.a. Sarandë nuk ka kthyer përgjigje;

Ujështetës Sh.a. Divjakë ka kthyer përgjigje brenda afatit me shkresën nr. 99/1, datë 03.11.2015;

Ujështetës Sh.a. Durrës ka kthyer përgjigje brenda afatit me shkresën nr. 2650/6, prot., datë 03.11.2015;

Ujështetës Sh.a. Patos ka kthyer përgjigje brenda afatit me shkresën nr. 203, prot., datë 29.10.2015;

Ujështetës Sh.a. Fier nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor për planin e masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH;

Ujështetës Sh.a. Mirditë ka kthyer përgjigje me shkresën nr.152/2 datë 06.11.2015,

Ujësjetllës Sh.a. Elbasan Qytet ka kthyer përgjigje me shkresën nr.1640 datë 30.10.2015,  
Ujësjetllës Sh.a. Kruje ka kthyer përgjigje me shkresën nr.301 datë 26.10.2015,  
Ujësjetllës Sh.a. Ura Vajgurore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 110/1 datë 29.10.2015,  
Ujësjetllës Sh.a. Pogradec ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 218/4 prot, datë 03.11.2015,  
Ujësjetllës Sh.a. Maliq ka kthyer përgjigje me shkresën nr.228 datë 28.10.2015,  
Ujësjetllës Sh.a. Tepelenë (Nuk ka kthyer përgjigje),  
Ujësjetllës Sh.a. Elbasan Fshat ka kthyer përgjigje me shkresën nr.294 prot, date 09.12.2015,  
së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

-Nga Ministria e Financave, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 7100/37, datë 27.10.2015 por nuk është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për njoftimin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

-Nga MZHETTS, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 7766/1, datë 29.10.2015 por nuk është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për njoftimin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

- “Ujësjetllës Sh.a. Mirditë,

Ujësjetllës Sh.a. Patos,

Ujësjetllës Sh.a. Durrës,

Ujësjetllës Sh.a. Kruje,

Ujësjetllës Sh.a. Sarandë,

Ujësjetllës Sh.a. Pogradec,

Ujësjetllës Sh.a. Maliq,

Ujësjetllës Sh.a. Tepelenë,

Ujësjetllës Sh.a. Divjakë,

Ujësjetllës Sh.a. Elbasan Fshat , nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

-Kanë kthyer përgjigje brenda afatit:

Ujësjetllës Sh.a. Elbasan-Qytet,

Ujësjetllës Sh.a.,Ura Vajgurore,

Ujësjetllës Sh.a. Fier.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

#### **Masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi**

Janë lënë 6 “Masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi ”, nga të cilat 5 janë pranuar. Masat e pranuar rezultojnë: të zbatuara 3 masa, realizuar pjesërisht 1 masë dhe në proces 1 masë.

#### **Masa Organizative:**

Nga KLSH, janë lënë 2 “Masa organizative”, për të cilat, rezultojnë zbatuar 2 masa.

#### **Masa Shpërblim dëmi:**

Nga KLSH, janë lënë 17 “Masa për shpërblim dëmi”, në vlerën 5,162,125 lekë nga të cilat janë zbatuar 3 plotësisht në vlerën 1,141,254 lekë, 10 janë zbatuar pjesërisht ku vlera e mbetur e paarkëtuar është 1,861,883 lekë dhe 4 janë në proces zbatimi me vlerë për tu arkëtuar 1,826,378 lekë.

Sa më sipër, i rikërkojmë MZHETTS dhe MF që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe përshpejtimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresat nr.527/197 deri në nr. 527/215 datë 10.10.2015, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht ose të papranuara.

## **A. MASA PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN**

### **Rekomandim 1**

Ministria e Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Zhvillimit Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes) të marrin masa për rishikimin tërësor të kuadrit rregullator referuar veprimtarisë së krijimit, përbërjes dhe shpërblimit të bordeve, këshillave, komisioneve apo organeve të tjera kolegjiale të administratës shtetërore, enteve publike, dhe shoqërive anonime në drejtimet si më poshtë vijon:

b) Për kufizimin e numrit të pjesëmarrjes në strukturave kolegjiale rekomandoj:

Funksionarëve politikë, nëpunësve civilë dhe punonjësve të administratës publike u ndalohet pjesëmarrja me të drejtë pagese në më shumë se një këshill, bord, komision apo organ tjetër kolegjial në njësitë e qeverisjes qendrore dhe në shoqëritë anonime.

-Përjashtohen nga kufizimi i mësipërm anëtarësimi me zgjedhje në Organet e Arsimit të Lartë Publik; i) Këshilli Administrativ ii) Senati Akademik iii) Këshilli i Fakulteteve.

c) Për kufizimin e pjesëmarrjes të kategorisë së punonjësve “Funksionarë kabinet” në përbërje të strukturave kolegjiale.

Në kuadrin e ri rregullator të vendoset kufizimi sipas të cilit: Përjashtohen nga pjesëmarrja në këshilla, borde, komisione apo organe të tjera kolegjiale punonjësit që në ligjin nr 152/2013 “Për nëpunësin civil” përfshihen në kategorinë “Funksionarë kabinet”.

d) Në kuadrin e ri rregullator të vendoset kufizimi sipas të cilit: Anëtarëve të Këshillit Drejtues të [REDAKTUAR] u ndalohet pjesëmarrja në borde/komisione/këshilla apo organe të tjera kolegjiale të administratës shtetërore apo enteve publike, përveç strukturave të fushës akademike dhe shkencore.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 3**

Në drejtim të përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes së kandidaturave për anëtar të Këshillave Mbikëqyrës në shoqëritë anonime, rekomandoj se nga MZHETTS të reflektohen në kuadrin e ri rregullator kriteret që duhet të përmbushin kandidaturat për të marrë pjesë në Këshilla Mbikëqyrëse. Rishikimi dhe ndryshimi i kriterëve të përzgjedhjes së emërimit të anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrëse në sh.a të synojë në përcaktimin e kriterëve specifike në drejtim të kualifikimeve, përvojës, eksperiencës dhe ekspertizës teknike që duhet të disponojë kandidati dhe që kanë lidhje organike me aktivitetin që zhvillon shoqëria anonime. Si kriter parësor duhet që kandidati të jetë personalitet i fushës, të emërohet nga strukturat shtetërore që kanë në administrim shoqërinë anonime shtetërore.

Si kriter i veçantë duhet të jetë dhe orientimi i kandidaturave si profesorë të universiteteve publike që janë profesionistë të fushës, gazetarë ekonomikë etj, pra individë të spikatur në fushën dhe aktivitetin që mbulon shoqëria.

*Menjëherë*

## **MASA SHPËRBLIM DËMI**

Ujësja Ujësja Mirditë

### **Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësja sh.a Mirditë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 709,650 lekë, respektivisht ndaj **Z. A. P** ish-kryetar i këshillit mbikëqyrës

për vlerën 425,790 lekë dhe **A. H** ish-antare e këshillit mbikëqyrës për vlerën 283,860 lekë dhe vlerën e mbetur nga **z. M. P.**

*Menjëherë*

Ujësjiellës sha Elbasan-Qytet

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Elbasan-Qytet, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik nga 7 personat në vlerën 280,357 lekë si më poshtë:

I. S, Kryetar i këshillit mbikëqyrës vlerën 84,332 lekë, antarët e Këshillit Mbikëqyrës respektivisht: K. Xh vlerën 7,552 lekë, Q .T vlerën 63,552 lekë, K. G vlerën 63,552 lekë dhe I B, vlerën 23,869 lekë dhe znj.A. I vlerën 37,500 lekë.

*Menjëherë*

Shoqërisë Ujësjiellës Krujë sh.a

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Krujë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik nga ish/anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, z.F. B shuma 65,025 lekë.

*Menjëherë*

Ujësjiellës Ura Vajguore sha

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Ura Vajguore, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 205,200 lekë, ndaj znj. B. P, aktualisht e papunë e emëruar në detyrën e Sekretares të Këshillit Mbikëqyrës Ujësjiellës sh.a Ura Vajguore.

*Menjëherë*

**Rekomandim2**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Ura Vajguore, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 45,900 lekë, ndaj z.N. D, punonjës auditit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, në cilësinë e antarit të Këshillit Mbikëqyrës në Ujësjiellës sh.a Ura Vajguore.

*Menjëherë*

Ujësjiellës Kanalizime sha Pogradec

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a Pogradec, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 135,000 lekë, ndaj zj. E. C, aktualisht i punësuar me detyrën e Sekretares në Ujësjiellës Kanalizime sha Pogradec .

*Menjëherë*

Ujësjiellës Tepelenë sh.a.

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sha Tepelenë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 35,000 lekë, ndaj z. I. S , aktualisht i pa punë, i emëruar në detyrën e sekretarit të këshillit mbikëqyrës Ujësjiellës sh.a Tepelenë.

*Menjëherë*

Ujësjiellës Sh.a. Sarandë

**Rekomandim1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Sarandë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 121,200 lekë, ndaj znj.T. Sh e emëruar në detyrën e sekretarit të këshillit mbikëqyrës Ujësjiellës sh.a Sarandë.

*Menjëherë*

Ujësjiellës Sh.a. Divjakë

**Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës sh.a Divjakë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **22,250 lekë**, ndaj z. **V. M**, aktualisht e punësuar me detyrën e specialistes së buxhetit në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik,

Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes e emëruar në detyrën e anëtares së këshillit mbikëqyrës dhe njëherazi padrejtësisht është paguar edhe me detyrën e sekretarit të këshillit mbikëqyrës të Ujësjetllës sh.a Divjakë.

*Menjëherë*

Ujësjetllës Sh.a. Patos

### **Rekomandim 1**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Patos, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 303,018 lekë, ndaj z. Sh. B, aktualisht i punësuar me detyrën e Juristit në Bashkinë Patos, i emëruar në detyrën e sekretarit të këshillit mbikëqyrës Ujësjetllës sh.a Patos.

*Menjëherë*

### **Rekomandim 2**

Nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës sh.a Patos, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 104,160 lekë, ndaj znj. A. Ç, në profesion të lirë avokate, Juriste, në cilësinë e nënkryetares të këshillit mbikëqyrës në Ujësjetllës sh.a Patos.

*Menjëherë*

(Nga Ujësjetllës Fier, Ujësjetllës Elbasan -Fshat, Ujësjetllës Korçë Fshat sh.a, rekomandimet janë zbatuar plotësisht)

## ***REKOMANDIME TË PAZBATUARA PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË DISA DREJTUESVE TË LARTË***

Nga auditimi konstatuam se nuk janë zbatuar rekomandimet për largim nga detyra të funksionarëve të lartë, si më poshtë:

**1-Nga auditimi i ushtruar në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Lushnjë për periudhën e veprimtarisë 01.05.2013 deri më datë 31.08.2015 dhe finalizuar me Vendimin nr. 172 datë 28.12.2015, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2015 është rekomanduar masë disiplinore për administratorin e shoqërisë si më poshtë vijon :**

**“Këshilli Mbikëqyrës të analizojë punën e z.A. D Administrator i Shoqërisë dhe të marrë masat e nevojshme administrative dhe disiplinore në përputhje me statutin e shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tij, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë”.**  
Për sa mësipër Këshilli Mbikëqyrës, në analizën e bërë për këtë qëllim, nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore.

**2-Nga auditimi i ushtruar në Ndërmarrjen “Trajtimi i Studentit Nr. 3” dhe finalizuar me Vendimin nr. 172, datë 28.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 801/6 prot, datë 28.12.2015 është rekomanduar masë disiplinore për administratorin e ndërmarrjes si më poshtë vijon :**

**“I lihet në kompetencë Këshilli Mbikëqyrës të marrë masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” për z. E. M, me detyrë Administrator i Ndërmarrjes “Trajtimi i Studentit Nr. 3”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit”.**

Referuar auditimit të zbatimit të rekomandimeve rezulton që Këshilli Mbikëqyrës nuk ka marrë vendim për marrjen e masës disiplinore për administratorin e shoqërisë.

**3-Nga auditimi i kryer në Autoritetin e Aviacionit Civil për periudhën e vitit 2014 deri në Prill të vitit 2016 në zbatim të vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr.190/7, datë 30.06.2016**

dhe përcjellë me shkresën 190/8, datë 30.06.2016 është rekomanduar masë disiplinore **për z. F. B me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv i AAC** si më poshtë vijon:

*“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”* .

Komisioni disiplinor i ngritur me urdhrin e titullarit të AAC me nr.473, datë 20.10.2016, ka marrë vendimin për ndërprerjen e procedimit disiplinor, duke konsideruar faktet e paraqitura të shkeljeve ligjore nga KLSH që nuk përbëjnë shkak për fillimin e procedurës disiplinore, duke mos dhënë argumente ligjore për faktet e paraqitura nga KLSH.

### **TË TJERA**

1. Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “k”, KLSH për mos zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, do të informojë me një përmbledhje mbi zbatimin e rekomandimeve Komisionin e Ekonomisë dhe Financave si dhe komisionet e tjera sipas fushave përkatëse, pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar edhe ndihmën për të sensibilizuar institucionet për rëndësinë e rekomandimeve në rritjen e përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike.

Kuvendi i Shqipërisë do të informohet dhe për subjektet që nuk kanë përgatitur plan veprimi dhe nuk kanë informuar për ecurinë e rekomandimeve brenda 6 muajve, në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

Ky informacion do të përcillet dhe titullarëve të ministrive nga varen subjektet me problematikat sa më sipër cituar.

2. Shkresat për rikërkimin e rekomandimeve të cilat nga auditimi rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe të pa pranuar, do të përcillen në subjekt përgjatë muajit Janar 2017.

Me ndjekjen dhe auditimin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Projekteve dhe Investimeve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**